



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 13/2020 (JR)  
Datë 01.06.2020

Vendim nr. 2 (JR)  
Datë 15.02.2022

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

- shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 15.02.2022, ditën e martë, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Darjel Sina.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 221, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Jella.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik Darjel Sina, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili kërkoi përfundimisht

ndryshimin e vendimit nr. 221, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, e cila kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar Tonçi Petković, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të deklarimit të pasurisë<sup>1</sup> duke konkluduar se: i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës, i ka përcjellë Komisionit raportin<sup>2</sup> duke konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Xh. Jella.

2.3. KLP-ja, për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Jella, i ka përcjellë Komisionit një raport<sup>3</sup> të arsyetuar për aftësitë profesionale.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 221, datë 10.12.2019, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, vendosi:

1. *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, prokurore dhe drejtuese në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.*
2. *Transferimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, të regjistruar në datën 10.03.2014, pranë organit kompetent për inspektim dhe vlerësim.*

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.07.2018.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2017 (raport i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. {\*\*\*}, datë 24.04.2019).

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.06.2019.

3. *Transferimin e dy çështjeve që lidhen me ndjekjen e procedurës si drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, pranë organit kompetent, për t'u marrë parasysht për vlerësimin periodik të subjektit të rivlerësimit [...].*
4. Këtë vendim Komisioni e ka mbështetur mbi konkluzionet e arritura për secilin nga kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat ka konkluduar si vijon.
- 4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, [...] *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë në përputhje me ligjin. Nga hetimi rezultoi se bilanci financiar është pozitiv dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka probleme me pasurinë dhe analizën financiare ndër vite, si dhe ka burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera. Në vlerësimin e përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*
- 4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, [...] *subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që të jetë e përfshirë, apo e vënë në presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen të përshtatshme për vazhdimin e detyrës. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*
- 4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, [...] *në vlerësim të informacioneve të mbledhura gjatë hetimit administrativ lidhur me denoncimet, trupi gjykues vlerëson se në asnjë rast nuk i referohen shkeljeve konkrete të bëra nga subjekti i rivlerësimit në dosjet penale të hetuara prej saj. Denoncimet trajtonin çështje që kishin të bënin me pozicionin e saj si drejtuese, të cilat në vlerësim, me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 97/2016, tregonin sjellje korrekte të subjektit të rivlerësimit në shumicën e rasteve të hetuara. [...] subjekti i rivlerësimit ka zbatuar ligjin brenda kompetencave të saj si drejtuese dhe se mosveprimet e saj të konstatuara në dy raste nuk mund të përbëjnë shkak për vlerësimin profesional të saj me mangësi apo të papërshtatshëm, referuar nenit 44 të ligjit nr. 84/2016. [...] subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Ajo ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës "c" të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

### III. Shkaqet e ankimit

5. Komisioneri Publik Darjel Sina, në mbështetje të rekomandimit<sup>4</sup> për paraqitje ankimi, të nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ka paraqitur ankim<sup>5</sup> kundër vendimit nr. 221, datë 10.12.2012, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella.
6. Ankimi i Komisionerit Publik evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana e fakte ligjore për të cilat subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës dhe për të cilat

<sup>4</sup> Shih rekomandimin e ONM-së nr. {\*\*\*} prot., datë 11.02.2020, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë:

<http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/02/11.Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-221-dat%C3%AB-10.12.2019.pdf>

<sup>5</sup> Shih ankimin e Komisionerit Publik me nr. {\*\*\*} prot., datë 25.02.2020, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë:

<http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/02/31.Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-221-dat%C3%AB-10.12.2019-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABSimit-znj.-Anita-Jella.pdf>

Komisioneri Publik çmon se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën, lidhur me: *i. deklarin e pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kontrollin e kriterit të pasurisë; ii. procedimin penal nr. {\*\*\*/2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës; iii. procedimin penal nr. {\*\*\*/2019<sup>6</sup>, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës; iv. procedimin penal nr. {\*\*\*/2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës; v. mungesën e koordinimit dhe ekzistencën e një sistemi efektiv dhe eficient të regjistrimit dhe shpërndarjes së procedimeve penale, konstatuar në muajin gusht të vitit 2019.*

7. Në referencë të përmbajtjes së pikës 2 të nenit 4, së pikës 1 të nenit 59, dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se gjykimi i çështjeve të lartpërmendura nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, duke kryer njëkohësisht një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

8. Shkaqet e ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, konsistojnë në:

**8.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë**

▪ Për pasurinë *apartament banimi, me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen nr. {\*\*\*}, rruga “{\*\*\*}”, nr. {\*\*\*}, kati i {\*\*\*}, Durrës.*

**8.1.1.** Në vlerësim të Komisionerit Publik, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mosdeklarimin e përdorimit të kësaj pasurie për vitet 2011 – 2016, nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe janë në kundërshtim me faktet e dala nga hetimi administrativ. Referuar dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë<sup>7</sup>, posedimi bën pjesë në të drejtat reale, e sipas nenit 4, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, në kontekstin e deklarin të pasurisë, përbënte detyrim ligjor për t’u zbatuar nga subjekti i rivlerësimit për vitet 2011 – 2016, përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 84/2016 dhe plotësimi i deklaratës *vetting*.

**8.1.2.** Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm, për shkak të mospërputhjeve së vlerave të kursimeve të përdorura për pagesën e këstit të parë të kësaj pasurie.

**8.1.3.** Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, kursimet në deklaratat periodike vjetore. Në përputhje me nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apellimit, shuma aritmetike e kursimeve në *cash* deri në fund të vitit 2010 rezulton 1.830.000 lekë, e cila nuk përputhet me shumën e saktësuar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, prej 2.200.000 lekësh dhe as me shumën e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, prej 2.500.000 lekësh, për pagesën e këstit të parë të apartamentit, me të ardhurat e kursyera ndër vite.

**8.2. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në analizë të provave dhe akteve të administruara, Komisioneri Publik vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i cenueshëm, pasi ai bazohet në një vlerësim jo të drejtë të fakteve dhe të ligjit të zbatueshëm.**

**8.2.1. Për procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014, provohet që hetimi penal i ndërmarrë nga subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i plotë dhe paraqet mangësi, pasi nuk rezulton të jetë krahasuar përmbajtja e deklaratës së të dyshuarit me rezultatet e analizave të ekspertimit të**

<sup>6</sup> Ky procedim penal, në rekomandimin për paraqitje ankimi të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe në ankimin e Komisionerit Publik, është referuar si procedimi nr. {\*\*\*/2019, ndërsa nga aktet e administruara që i përkasin këtij procedim penal, ai mban nr. {\*\*\*} i vitit 2019, referuar me këtë numër në përmbajtje të këtij vendimi.

<sup>7</sup> Referohuni në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 17.06.2014, të Gjykatës së Lartë.

ndërmarrja në kuadër të këtij hetimi, nga të cilat rezulton mospërputhje dhe në kushtet kur personi i dyshuar ishte person me precedent të mëparshëm penal, subjekti duhet t'u kishte kushtuar vëmendje këtyre rrethanave.

#### **8.2.2. Për procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019**

**8.2.2.a.** Ndryshimet e reja ligjore, përfshirë ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk duhen interpretuar në drejtim të mospërgjegjësisë, rolit mbështetës dhe mbikëqyrës të drejtuesit të Prokurorisë, rol të cilin ligji ia njeh me anë të kompetencave udhëzuese dhe me natyrë jodetyruese.

**8.2.2.b.** Subjekti i rivlerësimit posaçërisht për shkak të detyrës funksionale kishte të drejtën dhe detyrimin të verifikonte ecurinë dhe përfundimin e çështjes dhe në rastin konkret, mund të udhëzonte me shkrim kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 97/2016, përpara se prokurori i çështjes të merrte vendimin mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.

**8.2.2.c.** Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se bazuar në ndryshimet ligjore, drejtuesi i prokurorisë shfaqet thjesht si nënshkrues i shkresës përcjellëse dhe ecuria e procedimit penal është përgjegjësi vetëm e prokurorit, nuk e justifikon mosveprimin si drejtues i prokurorisë, referuar nenit 43 dhe 48 të ligjit nr. 97/2016. Parë në raport me raste të tjera të ngjashme (trajtuar në vijim) ku subjekti, duke shfrytëzuar pikërisht pozitën e drejtuesit dhe hapësirat e reja ligjore, si dhe duke ndërmarrë veprime aktive, vendos standard të ndryshëm në ecurinë e çështjes penale.

#### **8.2.3. Për procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019**

**8.2.3.a.** Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës dhe vendimmarrja e Komisionit është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**8.2.3.b.** Subjekti i rivlerësimit, në trajtimin e këtij procedimi penal, ka qenë në rolin e drejtuesit të prokurorisë dhe veprimet e tij duhen vlerësuar brenda kriterit të aftësive profesionale, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016 dhe për aq sa gjen zbatim ligji nr. 96/2016 i ndryshuar.

**8.2.3.c.** Në vlerësimin e këtij rasti, përtej shpjegimeve të dhëna mbi kompetencën e kufizuar ligjore në cilësinë e drejtueses, duke vepruar pikërisht në këtë cilësi, subjekti ka passjellë një seri ngjarjesh procedurale dhe vonesa të panevojshme, që duket sikur kanë synuar në mbrojtjen e personit nën hetim.

**8.2.4. Lidhur me çështjen e mungesës së koordinimit dhe ekzistencës së një sistemi efektiv dhe eficient të regjistrimit dhe shpërndarjes së procedimeve penale, konstatuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në muajin gusht të vitit 2019:**

**8.2.4.a.** Subjekti i rivlerësimit me shpjegimet dhe provat e paraqitura nuk arriti të provonte të kundërtën për sa i është kaluar barrë prove.

**8.2.4.b.** Nga kronologjia e ecurisë së veprimeve procedurale të ndërmarrja gjatë muajit gusht, në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Durrës, bie në sy mungesa e organizimit të një sistemi efektiv dhe eficient që, më së paku, ka vënë në rrezik cilësinë dhe rezultatet për procedimet penale aktive. Është fakt se në këtë situatë, rasti është trajtuar nga tre prokurorë të ndryshëm, të cilët kanë kryer veprime procedurale të ndryshme, e në disa raste të paregjistruara.

**8.2.4.c.** Përfshirja e tre prokurorëve të ndryshëm në fazat fillestare të hetimit, dhe pse bëhet fjalë për muajin gusht, nuk tregon menaxhim të duhur të burimeve të institucionit dhe sistemit të gatishmërisë, pasi modalitete të tilla mund të çojnë përfundimisht në dëmtim të vetë hetimit.

#### IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

###### a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisioneri Publik të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### b) Legjitimimi i ankuesit

10. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 221, datë 10.12.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Jella, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.

##### B. Aspekti procedural lidhur me shtrirjen e pranueshmërisë së ankimit të Komisionerit Publik

12. Në lidhje me pranueshmërinë e ankimit, Komisioneri Publik kundërshton disponimin në pikën 5 të dispozitivit të vendimit nr. 221, datë 10.12.2012, të Komisionit, sipas së cilit: *Pika 1 e këtij vendimi mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit [...]*, duke nënkuptuar se pikat 2 dhe 3 të dispozitivit përjashtohen nga e drejta e palëve për ankim, përfshirë dhe Komisionerin Publik. Në këtë kuptim, Komisioneri Publik arsyeton se nëse kufizimi i parashikuar në nenin 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 i shtrin efektet edhe ndaj tij, si një nga institucionet e rivlerësimit dhe përfaqësues i interesit publik, eventualisht do të binte ndesh me kompetencat e parashikuara nga pika 2 e nenit C dhe pika 2 e nenit F të Aneksit të Kushtetutës. Njëkohësisht ky fakt do të pamundësonte juridiksionin rivlerësues dhe kontrollues të vetë Kolegjit ndaj çështjeve të transferuara nga Komisioni, për të cilat Komisioneri Publik, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se kanë ndikim thelbësor në vlerësimin e drejtë të subjektit të rivlerësimit.

12.1. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik, Kolegji vëren se neni 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 përcakton se: *Pavarësisht se subjekti të rivlerësimit i jepet vendim për konfirmimin në detyrë, Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent*

*për inspektim në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, ose në rast se evidenton shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij. Ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim. Organi kompetent fillon menjëherë shqyrtimin e shkaqeve, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.*

**12.2.** Kjo dispozitë gjen zbatim në rastet kur subjekti i rivlerësimit, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, është konfirmuar në detyrë por që gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, janë evidentuar shkaqe të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore të një rëndësie të tillë, sa të vetme e në mënyrë të pavarur nuk mund të përbëjnë shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit, referuar nenit 58, pika 1, germa “c” dhe nenit 59, pika 2, lidhur me nenin 61, pika 4 apo 61 pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuptim, parashikimi i nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, legjitimon institucionin e rivlerësimit që në këtë rast të referojë çështjet pranë organit kompetent për inspektim, e për t’iu nënshtruar një juridiksioni tjetër, atij disiplinor, përgjatë kryerjes së të cilit, subjektit të rivlerësimit i garantohen të gjitha të drejtat për një proces të rregullt ligjor, përfshirë dhe të drejtën për të ushtruar ankim ndaj një vendimi eventual të organit kompetent.

**12.3.** Në kuadër të dispozitave të paketës ligjore të reformës në drejtësi dhe rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Venecias, me nenin 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 ligjvënësi ka pasur për qëllim kryerjen e një procesi rivlerësimi të shpejtë në kohë, duke shmangur tentativën e subjekteve të konfirmuara në detyrë për të ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, e duke vënë në lëvizje juridiksionin rivlerësues të tij, vetëm për shkak të transferimit të çështjeve pranë organit kushtetues kompetent për procedimin disiplinor.

**12.4.** Në interpretim të parashikimeve kushtetuese, përkatësisht neni C, pika 2<sup>8</sup> dhe neni F, pika 2<sup>9</sup> e Aneksit të Kushtetutës, Komisioneri Publik legjitimohet në ushtrimin e së drejtës së ankimit ndaj vendimeve të Komisionit, pa ndonjë kufizim në këtë të drejtë. Në kuadër të interesit publik që përfaqësojnë Komisionerët Publikë, në zbatim të dispozitave të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se transferimi i procedimit penal nr. {\*\*\*/2014 pranë organit kompetent për inspektim dhe vlerësim, si dhe i procedimeve penale nr. {\*\*\*/2017 dhe {\*\*\*/2017, që lidhen me ndjekjen e procedurës si drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, pranë organit kompetent, për t’u marrë parasysh për vlerësimin periodik të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të përjashtohen nga objekti i ankimit të Komisionerit Publik, për sa kohë ky i fundit çmon se vlerësimi i Komisionit nuk ka qenë i drejtë apo i plotë. Transferimi pranë organit kompetent i këtyre çështjeve bëhet në ato raste kur vendimi i Komisionit për konfirmim në detyrë i subjektit të rivlerësimit nuk do të ankimohej nga Komisioneri Publik dhe do të merrte formë të prerë. Me konsideratë qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën<sup>10</sup> e tij, Kolegji vlerëson se pretendimi i Komisionerit Publik është i drejtë dhe disponimi i Komisionit në pikën 5 të dispozitivit të vendimit nr. 221, datë 10.12.2019, i cili ndalon Komisionerin Publik për të ushtruar ankim ndaj çështjeve për të cilat është vendosur transferim pranë organeve kompetente për inspektim, është i pabazuar. Për këto arsye, procedimet penale iu nënshtruan shqyrtimit gjyqësor në Kolegji.

- 13.** Në kuadër të veprimeve përgatitore të çështjes, janë ftuar palët në këtë proces, subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, që të depozitojnë në Kolegji parashtrimet e tyre së bashku me aktet që kërkojnë të merren në cilësinë e provës në gjykim, në mënyrë që këto parashtrime

<sup>8</sup> Neni C, pika 2: “Dy komisionerë publikë përfaqësojnë interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit”.

<sup>9</sup> Neni F, pika 2: “Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2, të Aneksit”.

<sup>10</sup> Shih vendimin nr. 2/2020 (JR), paragrafët 15.2 deri 15.7, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

dhe akte t'u komunikohen reciprokisht palëve në proces dhe për dijeni Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, për efekt të një ekonomie gjyqësore dhe të menaxhimit sa më efikas të procesit gjyqësor. Gjithashtu, subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik u janë vënë në dispozicion dhe denoncimet nga publiku të depozituara në Kolegj.

14. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në seancën gjyqësore publike të datës 15.12.2021, subjekti i rivlerësimit në vijim të parashtrimeve, kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja që i shërbejnë hetimit të plotë dhe të gjithanshëm të kësaj çështjeje. Trupi gjykues i Kolegjit, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore<sup>11</sup> të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

---

<sup>11</sup> i. Shkresat nr. {\*\*\*} prot., nr. {\*\*\*} prot., nr. {\*\*\*} prot., të datës 15.11.2021, ASHK, Drejtoria Vendore Durrës; ii. Vendim i Gjykatës së Lartë nr. {\*\*\*}, dt. 17.06.2014, printuar nga web; iii. kërkesë, datë 24.06.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, së bashku me shkresën nr. {\*\*\*} prot., dt. 24.06.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe procesverbalin e seancës; iv. shkresë nr. {\*\*\*} prot., dt. 23.07.2021, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me lëndë “Njoftim mbi vendimin e arkivimit pas shqyrtimit fillestar”; v. vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. {\*\*\*}, i datës 24.10.2019; vi. apelim i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës kundër vendimit nr. {\*\*\*} të datës 24.10.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Durrës; vii. vendim i Gjykatës së Apelit Durrës nr. {\*\*\*}, i datës 17.01.2020; viii. vendim i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës “Për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve”, i datës 20.02.2020; ix. shkresë nr. {\*\*\*} prot., e datës 05.03.2020, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me lëndë “Ridërgim për kompetencë i akteve të procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2019”; x. shkurtim vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. {\*\*\*}, i datës 06.12.2021; xi. kërkesë “Për pushimin e çështjes”, e datës 09.11.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Durrës; xii. vendim i Gjykatës së Apelit Durrës nr. {\*\*\*}, i datës 22.12.2020, i dhënë për çështjen gjyqësore me objekt “Pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2019”; xiii. kërkesë për pushimin e çështjes, datë 22.09.2020, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; xiv. vendim nr. {\*\*\*}, dt. 11.12.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; xv. informacion për procedimin penal nr. {\*\*\*}, dt. 13.03.2019; xvi. shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 18.09.2019, “Dërgohet kërkesa për lejim përgjimi të telekomunikimeve” drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; xvii. shkresë nr. {\*\*\*} prot., dt. 19.09.2019, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, me lëndë “Dërgohet për ekzekutim vendimi”, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme; xviii. kërkesë për caktim mase sigurimi, datë 22.10.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; xix. vendim nr. {\*\*\*}, dt. 23.10.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “Caktim mase sigurimi”; xx. kërkesë për informacion dhe vënie e akteve në dispozicion, e dt. 01.10.2021, drejtuar prokurorit N. T.; xxi. informacion me nr. {\*\*\*} prot., dt 07.12.2021, drejtuar drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës [bashkëlidhur të cilit administrohet: Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq; kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim nr. {\*\*\*} prot., datë 30.12.2020; urdhër për regjistrimin e procedimit penal dhe emrin e personit të cilit i atribuohet vepra, datë 11.08.2019; procesverbal “Për ndalimin e të dyshuarit për një krim”; shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 13.08.2019, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; kërkesë për vleftësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal”; shkurtim vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.08.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 28.08.2019, e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës; vendim nr. {\*\*\*}, datë 29.08.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; vendim nr. {\*\*\*}, datë 07.06.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; shkurtim vendimi nr. {\*\*\*}, datë 06.12.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; xxii. urdhrat me nr. {\*\*\*} prot., nr. {\*\*\*}, dt. 30.07.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; xxiii. grafiku i “Lejeve Vjetore të Administratës” dhe grafiku i “Lejeve Vjetore të Prokurorëve” për muajin gusht 2020; xxiv. shkresë nr. {\*\*\*} prot., dt. 30.07.2020, me lëndë “Grafiku i gatishmërisë për administratën për muajin gusht 2020”; xxv. shkresë nr. {\*\*\*} prot., dt. 30.07.2020, me lëndë “Grafiku i gatishmërisë për muajin gusht 2020”; xxvi. urdhër “Për miratimin e lejeve vjetore dhe mbarëvajtjen e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për muajin gusht 2021”, lëshuar më datë 30.07.2021, me nr. {\*\*\*} prot.; xxvii. urdhër me nr. {\*\*\*}, dt. 30.07.2021, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për dërgimin dhe tërheqjen e postës sekrete; xxviii. grafiku i lejeve vjetore për prokurorët, oficerët dhe administratën për periudhën gusht 2021; grafiku i gatishmërisë për prokurorët dhe oficerët për muajin gusht 2021, me nr. {\*\*\*}, dt. 30.07.2021; xxix. grafiku i gatishmërisë për administratën, për muajin gusht 2021, me nr. {\*\*\*}, dt. 30.07.2021; xxx. shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 06.12.2021, “Kthim-përgjigje”, dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan; xxxi. shkresë nr. {\*\*\*} prot., dt. 06.12.2021, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, bashkëlidhur urdhër nr. {\*\*\*} prot., dt. 30.07.2019, dhe grafik i gatishmërisë, muaji gusht 2019; xxxii. e-mail i drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, z.



C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me shkaqet të ankimit

I. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

15. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mosdeklarimin e përdorimit të apartamentit të banimit, me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen nr. {\*\*\*}, rruga “{\*\*\*}”, nr. {\*\*\*}, kati i {\*\*\*}, Durrës, për vitet 2011 – 2016, nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe janë në kundërshtim me faktet e dala nga hetimi administrativ, pasi referuar dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, posedimi bën pjesë në të drejtat reale dhe deklarimi i pasurive të paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, ka qenë detyrim ligjor për t’u zbatuar nga subjekti i rivlerësimit sipas nenit 4, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 84/2016 dhe plotësimi i deklaratës *vetting*, trupi gjykues i Kolegjit konstaton si vijon.

15.1. Nga analizimi i deklaratës së pasurisë *vetting*, rezulton që subjekti ka deklaruar: *apartament banimi i ndodhur në pallatin me nr. {\*\*\*}, në lagjen nr. {\*\*\*}, rruga “{\*\*\*}”, me nr. {\*\*\*}, kati i {\*\*\*}, me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>. (Deklaruar nga bashkëshorti E. Sh. në deklaratën periodike të vitit 2012, bazuar në deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 08.10.2016 [...], si dhe kontratës së sipërmarrjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol. datë 26.08.2011 [...] në emër të bashkëshortit). Në vlerën 67.900 euro.*

15.2. Referuar akteve të dosjes gjyqësore, ky apartament fillimisht është porositur nga kunati i subjektit, z. A. Sh., nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes së ndërtimit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.03.2010, nënshkruar me palën investitore, shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me përfaqësues ligjor F. V., në vlerën 71.190 euro. Me të njëjtën shoqëri ndërtimore, vitin pasardhës, më datë 26.08.2011, nënshkruhet kontrata e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., me porositëse E. Sh., bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, për apartamentin me nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe 97 m<sup>2</sup>, ndodhur në katin e {\*\*\*}, në të njëjtën godinë banimi, në vlerën 67.900 euro. Për këtë pasuri, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: kontratë sipërmarrjeje me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.08.2011, me palë investitore shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, për apartamentin me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 97 m<sup>2</sup>, në çmimin 67.900 euro.

15.3. Të dyja kontratat e sipërmarrjes, të nënshkruara me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në nenin 6 parashikojnë se kontrata nuk mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga palët kontraktuese, me përjashtim në rastin kur palët bien dakord për një gjë të tillë, në marrëveshje mes tyre, duke bërë revokimin me deklaratë noteriale të përbashkët dhe për revokimin e kësaj kontrate duhet të njoftojnë njëri-tjetrin dy muaj përpara. Në rastin e zgjidhjes së kontratës, pala sipërmarrëse është e detyruar t’i kthejë palës porositëse shumën e parapaguar, por kjo shumë do t’i kthehet porositësit kur apartamenti, objekt i kësaj kontrate, do të shitet në favor të një personi të tretë.

15.4. Nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.10.2016, mes palëve kontraktuese të kontratave të sipërmarrjes, konkretisht administratori dhe ortaku i vetëm i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. F. V., si dhe porositësit E. Sh. e A. Sh., bëhet këmbimi i apartamentit të porositur më datë 26.07.2011 dhe atij të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në këtë deklaratë noteriale, administratori i shoqërisë, z. F. V., deklaron se është plotësisht dakord që z. E. Sh., në këmbim të heqjes dorë nga apartamenti i përfituar me kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.08.2011, të

---

A. M., dt.09.12.2021, për vënie në dispozicion të urdhrorit me nr. {\*\*\*}, dt.27.07.2021, për gatishmërinë e vitit 2021, së bashku me grafikun.

përfitojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që vijnë për një tjetër apartament, i cili ka nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 113 m<sup>2</sup>, i ndodhur në katin e {\*\*\*} të banimit në të njëjtin objekt. Në këtë deklaratë, shpreh dakordësinë edhe deklaruesi E. Sh. Të dy deklaruesit deklarojnë se, *përveç këmbimit të apartamentit, kushtet e tjera nuk do të pësojnë ndryshime dhe se referimet do t'i bëhen kontratës cituar më lart*. Në këtë deklaratë jep pëlqimin dhe A. Sh., si palë kontraktore me shoqërinë investitore “{\*\*\*}” ShPK për këtë apartament, referuar *kontratës së sipërmarrjes së ndërtimit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.03.2010*, pasi ka hequr dorë nga të drejtat e pronësisë për apartamentin që i kalon z. E. Sh., duke mos pasur pretendim për këtë pasuri, sot e në të ardhmen, as nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, as nga z. E. Sh.

**15.5.** Në deklaratat periodike vjetore të periudhës 2012 deri 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi: “Lagjja nr. {\*\*\*}, rr. “{\*\*\*}”, Durrës”. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, për periudhën dhjetor 2011 e në vazhdim, ka banuar në adresën *lagjja nr. {\*\*\*}, rruga “{\*\*\*}”, pallati {\*\*\*}, kati i {\*\*\*} banim, hyrja {\*\*\*}, Durrës*. Subjekti i rivlerësimit pretendon se deri në vitin 2016, sipas ndryshimit të bërë me ligjin nr. 42/2017, datë 06.04.2017<sup>12</sup>, për deklarimin e të drejtave reale mbi to sipas Kodit Civil, nuk ka qenë e detyrueshme dhe nuk kërkohej deklarimi i sendeve të paluajtshme në përdorim. Akomodimi sipas saj është bërë që në fillim në apartamentin ku jeton aktualisht, duke hequr dorë nga apartamenti në katin e dytë e duke mos pasur më interes për të. Arsyeja për përdorimin e apartamentit të kontraktuar nga kunati, sipas subjektit, ishte domosdoshmëria për banesë dhe fakti se ky apartament i porositur rreth një vit e gjysmë më përpara ishte pothuajse gati për banim. Në deklaratat periodike, sipas subjektit, është dhënë adresa e banimit e cila është e njëjtë për të dyja apartamentet pasi ndodhen në të njëjtin pallat, duke vlerësuar po kështu që kontrata e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.08.2011, ishte në fuqi deri në vitin 2016, për aq kohë sa nuk ishte bërë ligjërisht zgjidhja ose ndryshimi i saj. Subjekt i rivlerësimit deklaroi se shkëmbimi i dy apartamenteve nuk mund të bëhej më parë pasi apartamenti ku banonte nuk figuronte në emër të shoqërisë, por të kunatit të subjektit të rivlerësimit, z. A. Sh., dhe ky i fundit nuk ishte likuiduar ende nga shoqëria për çmimin që kishte paguar paraprakisht.

**15.6.** Në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim identifikimin e kontratave të lidhura me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike [OSHEE], nga Komisioni u administruan disa shkresa lidhur me kontratat për furnizimin me energji elektrike të godinës ku ndodhen dy apartamentet e kontraktuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe vëllai i tij. Konkretisht, OShEE<sup>13</sup> informon Komisionin se me gjeneralitetet E. Sh., referuar sistemit të faturimit në instancën Durrës, identifikohet 1 abonent me kontratën e furnizimit me nr. {\*\*\*}, kontratë aktive e hapur më datë 12.08.2014. Për periudhën para lidhjes së kësaj kontrate, nga vetë subjekti i rivlerësimit u depozituan në Komision dy shkresa<sup>14</sup> të OSHEE-së, sipas të cilave për periudhën nga 2010 deri në shtator 2014, pallati i ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK është furnizuar nga kontrata e kantierit me kod {\*\*\*}.

**15.7.** Në parashtrimet para Kolegjit, në konsekuencë me ato në Komision, subjekti i rivlerësimit deklaroi se i vetmi apartament që ka përfutur nga marrëdhënia juridike e shitjes me shoqërinë ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK, është apartamenti në të cilin banon aktualisht. Apartamenti i porositur në fillim nga bashkëshorti me kontratë sipërmarrjeje me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.08.2011, nga i cili u hoq dorë me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.10.2016, i mbeti njërit prej pronarëve të truallit, z. F. T., sipas përcaktimit në

<sup>12</sup> Ligji nr. 42/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar”.

<sup>13</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.04.2019 dhe me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.07.2019;

<sup>14</sup> Shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 19.04.2019, nr. {\*\*\*} prot., datë 05.07.2019, nr. {\*\*\*} prot., datë 15.07.2019 dhe nr. {\*\*\*} datë 21.11.2019.

kontratën fillestare, *aneks kontrate nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.08.2009 (lidhur me kontratën e sipërmarrjes së ndërtimit nr. rep. {\*\*\*} dhe nr. kol. {\*\*\*}, datë 02.03.2009)*, mes palës investitore shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe palës pronare e truallit F. T. dhe B. T. Subjekti i rivlerësimit më herët në Komision kishte depozituar deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.11.2019, të z. F. V., sipas së cilës shtetasi F. T. posedon tri hyrjet e ndodhura në katin e dytë, nga të cilat hyrjet 2 dhe 3 i ka bashkuar në një të vetme. Ky fakt deklarohet<sup>15</sup> dhe nga shtetasi B. T.

**15.8.** Në kushtet kur shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk ndërmori procedurat ligjore për regjistrimin e *godinës 12 kate + 1 kat nëntokë* pranë Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (në vijim “AShK”), banorët kanë ndjekur procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje. Për të provuar këtë fakt, subjekti i rivlerësimit, në mbështetje dhe të parashtrimeve, ka depozituar në Kolegj shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.11.2021, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, me të cilën i njoftohet dhe dërgohet vendimi nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2021, “Për legalizimin e ndërtimit pa leje”, në emër të z. E. Sh., si dhe genplani dhe planimetria e apartamentit. Gjithashtu, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit depoziton shkresën {\*\*\*} prot., datë 15.11.2021, dhe shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.11.2021, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Durrës, nëpërmjet të cilave i njofton dhe i dërgon z. F. T. vendimet nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2021 dhe nr. {\*\*\*}, datë 11.11.2021, “Për legalizimin e ndërtimit pa leje”, që i referohet, sipas subjektit, edhe apartamentit të dorëzuar në këmbim.

**15.9.** Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik mbi mosdeklarimin nga subjekti i rivlerësimit të përdorimit të apartamentit me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup> për vitet 2011 – 2016, në mbështetje të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues çmon se deklaratat e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë në ILDKPKI, në kuadër të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, mund të përdoren si provë në procesin e rivlerësimit. Këtë cilësim ua njihet vetë ligji i posaçëm nr. 84/2016 në nenin 32, pika 5 e tij, për të provuar nëpërmjet tyre deklaratimet e bëra në deklaratën *vetting*. Në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, konkretisht parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, për efekt të këtij procesi, objekt i kontrollit të institucioneve të rivlerësimit janë deklaratimet e bëra në deklaratën e pasurisë *vetting*. Pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar të drejtën e përdorimit si të tillë në deklaratat periodike vjetore, ai ka deklaruar adresën e banimit e cila përkon me apartamentin në të cilin subjekti ka banuar dhe ka fituar më pas pronësinë. Në këtë kuptim, nga analiza nuk rezulton ndonjë sjellje e subjektit e cila, nëpërmjet mosdeklarimit, të ketë synuar fshehjen e ndonjë marrëdhënieje pasurorë e që do të përbënte rrethanë që duhej vlerësuar e analizuar nga Kolegji në këtë drejtim. Në kushtet kur nuk konstatohet një rrethanë e tillë faktike, mbetet për t’u vlerësuar mosdeklarimi i së drejtës së përdorimit në kuadër të saktësisë së deklaratimeve, të cilat verifikohen me këtë status sipas atyre që janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*. Mosdeklarimi i së drejtës së përdorimit të këtij apartamenti në deklaratat e interesave privatë periodike, konsiderohet një çështje e cila del jashtë sferës së kontrollit të deklaratimeve në kuadër të procesit të rivlerësimit, përderisa kjo e drejtë është deklaruar saktë dhe plotësisht në deklaratën e pasurisë *vetting*. Për pasojë, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

- 16.** Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, për shkak të mospërputhjeve midis vlerave të kursimeve të deklaruara për pagesën e kështit të parë të apartamentit, referuar deklaratave periodike vjetore, deklaratës së pasurisë *vetting* dhe shpjegimeve gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton si vijon.

<sup>15</sup> *Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.11.2019*

**16.1.** Nga analizimi i deklaratave të depozituara në ILDKPKI, rezulton se në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, deklaroi: *kontratë sipërmarrjeje me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.08.2011 [...], me porositës E. Sh. dhe me palë investitore shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. [...] për apartamentin me nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 97 m<sup>2</sup> [...] Burimi: kursime nga pagat dhe kredinë e marrë te BKT, [...] paguar 2 këste në shumën 55 mijë euro. [...] Dy këstet e para të likuiduara janë paguar me anë të kursimeve të bashkëshortes në vite nga paga si prokurore dhe me anë të kredisë së marrë për shtëpi në shumën prej 5.650.000 lekësh.*

Ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se *burimi për blerjen e këtij apartamenti është kredi në Bankën Kombëtare Tregtare në vlerën 5.650.000 lekë, si dhe me kursimet e deklaruara në vite ka kontribuar në pagesën e kësteve për apartamentin e deklaruar nga bashkëshorti sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.08.2011 dhe deklaratës noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.10.2016, gjithsej 2.500.000 lekë.*

**16.2.** Referuar kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.08.2011, mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe z. E. Sh., sa i përket mënyrës së shlyerjes së pagesës së çmimit të apartamentit të porositur, në nenin 4 të saj përcaktohet se çmimi prej 67.900 eurosh do të likuidohet me këste, si vijon: i) *kësti i parë* prej 15.000 euro, u likuidua ditën e nënshkrimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale, ii) *kësti i dytë* në shumën 40.000 euro brenda datës 25.10.2011, iii) *kësti i tretë dhe i fundit* në shumën 12.900 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes. Referuar deklaramentit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, personi i lidhur ka deklaruar se *dy këstet e para të likuiduara janë paguar me anë të kursimeve të bashkëshortes në vite nga paga si prokurore dhe me anë të kredisë së marrë për shtëpi në shumën prej 5.650.000 lekë.*

**16.2.a.** Lidhur me këstin e parë prej 15.000 eurosh, nga analizimi i deklaramenteve periodike vjetore të subjektit, për periudhën 2003 – 2010 rezultojnë të jenë deklaruar kursimet në *cash* si më poshtë:

1. Në vitin 2003: *Nuk deklaroi kursime cash.*
2. Në vitin 2004: *Gjendje në cash 300.000 lekë.*
3. Në vitin 2005: *Gjendje në cash 500.000 lekë.*
4. Në vitin 2006: *Gjendje në cash nga kursimet nga paga 700.000 lekë.*
5. Në vitin 2007: *Kursimet nga paga në cash, mbajtur në shtëpi 520.000 lekë.*
6. Në vitin 2008: *Kursime nga paga, në cash, në shtëpi 450.000 lekë.*
7. Në vitin 2009: *Kursime nga paga, cash në shtëpi 160.000 lekë.*
8. Në vitin 2010: *Nuk deklaroi ndryshime në kursime në cash.*

**16.2.b.** Ndërsa për këstin e dytë, nga aktet në dosje rezulton e provuar se pagesa e këstit të dytë është likuiduar nëpërmjet *kontratës së kredisë bankare nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.11.2011*, nënshkruar mes Bankës Kombëtare Tregtare ShA, Agjencia Peqin dhe kredimarrës E. Sh., dorëzantës Anita Jella. Nëpërmjet kësaj kontrate dhe aneksit të saj, banka akordon në favor të kredimarrësit shumën 5.650.000 lekë, për një afat 240 muaj. Sipas kontratës, shuma e kredisë së disbursuar do të përdoret për likuidimin e blerjes së apartamentit dhe do të transferohet nga llogaria e kredisë në llogarinë e shitësit të objektit shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së. Sipas informacionit<sup>16</sup> të përcjellë nga Banka Kombëtare Tregtare ShA, kjo kredi është disbursuar më datë 15.11.2011 dhe është transferuar në llogarinë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK më datë 16.11.2011, me emërtimin “Pagesë çmimi për blerje apartamenti”.

<sup>16</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.04.2019.

**16.3.** Për t'iu rikthyer pagesës së këstit të parë që përbën dhe shkak ankimor, rezulton se gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet pyetësorit të datës 17.06.2019, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit saktësimin e *gjendjes së likuiditeteve cash në fund të çdo viti* për periudhën 2003 – 2018. Në përgjigjet e datës 25.06.2019, subjekti i rivlerësimit shpjegon se gjendja e këtyre likuiditeteve në *cash* në fund të çdo viti (*deklaruar vetëm shitesat për çdo vit deklarimi*) ka qenë si më poshtë vijon:

1. Viti 2003: *Nuk ka likuiditete cash në fund të vitit.*
2. Viti 2004: *Likuiditete në cash në shumën 300.000 lekë në fund të vitit.*
3. Viti 2005: *Likuiditete në cash në shumën 800.000 lekë në fund të vitit.*
4. Viti 2006: *Likuiditete në cash në shumën 1.500.000 lekë në fund të vitit.*
5. Viti 2007: *Likuiditete në cash në shumën 2.002.000 lekë në fund të vitit.*
6. Viti 2008: *Likuiditete në cash në shumën 2.470.000 lekë në fund të vitit.*
7. Viti 2009: *Likuiditete në cash në shumën 2.630.000 lekë në fund të vitit.*
8. Viti 2010: *Likuiditete në cash në shumën 2.200.000 lekë në fund të vitit.*
9. Viti 2011: *Nuk ka likuiditete cash në fund të vitit[...].*

**16.4.** Lidhur me mospërputhjet midis vlerës së deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, nga subjekti i rivlerësimit për pagesën e këstit të parë prej 2.500.000 lekësh dhe vlerës së deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision prej 2.200.000 lekësh si gjendje e kursimeve *cash* në fund të vitit 2010, të cilat kanë shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit, në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011 është pasqyruar fakti i pagesës së këstit të parë për blerjen e apartamentit prej 15.000 eurosh, ose rreth 2.050.000 lekësh, ndërkohë që në këtë vit janë bërë shpenzime për rregullime të brendshme të apartamentit në vlerën rreth 450.000 lekë, nga të cilat janë përdorur pjesa e ngelur nga kursimet prej 2.200.000 lekësh në fund të vitit 2010, prej 150.000 lekësh dhe pjesa tjetër prej 300.000 lekësh nga kursimet e vitit 2011. Sipas subjektit, në deklaratën e pasurisë *vetting* të vitit 2016, është deklaruar ekzaktësisht se për blerjen e apartamentit janë përdorur kursimet nga paga prej 2.500.000 lekësh. Në deklaratën e pasurisë *vetting* është deklaruar e gjithë vlera totale e kursimeve e përdorur për apartamentin, konkretisht pagesa e këstit të parë prej 15.000 eurosh, konvertuar në rreth 2.050.000 lekë, plus vlerën e rregullimeve prej 450.000 lekësh, të shpenzuara në vitin 2011, në total 2.500.000 lekë. Ndërsa sa i përket diferencës në shumën 430.000 lekë nga viti 2009 në vitin 2010, subjekti në përgjigjet e datës 17.07.2019, ka sqaruar Komisionin se kjo diferencë vjen si pasojë e një trajtimi mjekësor në Angli në vitin 2010. Duke qenë se trajtimi mjekësor është kryer në muajt shkurt – mars 2010, për të përballuar kostot është përdorur një pjesë e kursimeve *cash* ndër vite, që subjekti ka pasur gjendje. Si rezultat i të ardhurave të marra gjatë vitit 2010, është zëvendësuar deri në fund të vitit pjesa e kursimeve të shpenzuara, dhe në përfundim ka mbetur pa u mbuluar vlera prej 430.000 lekësh.

**16.5.** Sa i përket diferencës së çmimit mes dy apartamenteve, konkretisht kontratës së sipërmarrjes të nënshkruar nga A. Sh. në vlerën 71.190 euro dhe kontratës së nënshkruar nga E. Sh., në vlerën 67.900 euro, gjatë hetimit administrativ në Komision subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se diferenca në çmim prej 3.290 eurosh, e konvertuar në vlerën prej 450.000 lekësh, konsiston në investimin e kryer në apartament në vitin 2011, për këtë arsye në deklaratën e shkëmbimit nuk ka ndryshuar çmimi i apartamentit. Në parashtrimet mbi shkaqet e ankimit të depozituara në Kolegj nga Komisioneri Publik, pretendohet se këto shpenzime që kanë mbuluar diferencën e çmimeve mbeten në nivel deklarativ, të paprovuara me dokumentacion, të padeklaruara në deklaratën periodike vjetore dhe që nuk përputhen me diferencën midis kursimeve të deklaruara të poseduara deri në fund të vitit 2010 dhe atyre të deklaruara në deklaratën *vetting*. Në parashtrimet e tij në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të

pretendimeve të Komisionerit Publik, shpjegon se detyrimi ligjor për deklarimin e shpenzimeve të deklarueshme u miratua më vonë, me ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, të miratuara në vitet 2012 dhe 2014.

**16.6.** Në mbështetje të sa analizuar më sipër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë i qartë në deklaratimet e tij, si në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu edhe në ato periodike. Nga analiza e të gjithë të dhënave që kanë rezultuar nga hetimi, nuk konstatohet mospërputhje e deklaratimeve, të cilat mund të kualifikonin situatën si deklaratim i pasaktë sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Deklarimet lidhur me burimin e kështit të parë të apartamentit, të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2011 si *kursimet e bashkëshortes në vite nga paga si prokurore*, përputhen me deklarimin nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting: me kursimet e deklaruara në vite, kam kontribuar në pagesën e kësteve për apartamentin e dekluar nga bashkëshorti*. Ndërsa sa u përket vlerave të deklaruara prej 15.000 eurosh në vitin 2011 me vlerën 2.500.000 lekë në deklaratën *vetting*, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë konsequent në deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ, duke sqaruar se vlera prej 2.500.000 lekësh, është e përbërë prej 2.050.000 lekësh pagesa e kështit të parë (konvertimi i 15.000 eurove) dhe shpenzimet për punimet e kryera në apartament prej 450.000 lekësh. Po kështu, në konsideratë edhe të përmbajtjes së kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.08.2011, sipas së cilës kësti i parë prej 15.000 eurosh është paguar ditën e nënshkrimit të saj, Kolegji konkludon se shuma e cila duhet t'i nënshtrohet analizës dhe vlerësimit në përgjigje të shkakut të ankimit, që lidhet me kështin e parë, është vlera prej 15.000 eurosh. Mbi këtë shumë do të vijojë edhe analiza më tej mbi burimet e përdorura për të justifikuar krijimin e saj.

17. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se, referuar deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, në përputhje edhe me nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, shuma aritmetike e kursimeve në *cash* deri në fund të vitit 2010 rezulton 1.830.000 lekë, trupi gjykues konstatoi se:

**17.1.** Komisioneri Publik arsyeton se në kushtet kur në deklaratat e interesave privatë të viteve 2004 - 2006, subjekti deklaroi si kursime në *cash*, duke iu referuar me termin *gjendje në cash në fund të vitit*, ndërsa në deklaratat e viteve 2007 – 2010 deklaroi kursime në *cash* duke iu referuar me termin *kursime nga paga në cash në shtëpi*, në asnjë prej deklaratave periodike vjetore, subjekti nuk deklaroi shtesat apo pakësimet e kursimeve, vetëm gjatë hetimit administrativ ka shpjeguar se në deklaratat periodike vjetore janë deklaruara shtesat e kursimeve në *cash*. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, kursimet në *cash* në banesë, shtesat dhe pakësimet duhet të konsiderohen sipas deklaratimeve në deklaratat periodike vjetore, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, rezultoi se shuma aritmetike e kursimeve deri në fund të vitit 2010 është 1.830.000 lekë. Trupi gjykues konstatoi se kjo vlerë e pretenduar nga Komisioneri Publik, vjen si rezultat i faktit se për vitet 2004 – 2006, konsiderohet që gjendja e kursimeve në *cash* e subjektit të rivlerësimit është në vlerën 700.000 lekë, duke prezumuar se kjo shumë përfshin dhe kursimet nga vitet e mëparshme. Në vijim të kësaj logjike, shuma 1.830.000 lekë vjen si rezultat i mbledhjes aritmetike të kursimeve në vitet 2006 – 2009 [700.000 lekë në 2006 + 520.000 lekë në 2007 + 450.000 lekë në 2008 dhe 160.000 lekë në 2009], meqë në vitin 2010 nuk janë deklaruara kursime në *cash*. Ashtu si shpjeguar nga subjekti i rivlerësimit, këto deklarime janë bërë në përputhje me frymën e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, i cili përcakton rregullin se deklarohen ndryshimet vjetore të pasurisë, përfshirë dhe ndryshimin e gjendjes së likuiditetit jashtë sistemit bankar, por jo totalin e gjendjes së likuiditeteve, duke pasqyruar faktin se ajo që pretendon subjekti vjen në përputhje me parashikimin ligjor dhe përfaqëson rregullin, i cili duhet të zbatohet prej

subjekteve në deklaram. Nevoja e shpjegimeve prej subjektit të rivlerësimit në këtë rast vjen për shkak të mënyrës së përshkrimit të këtyre pasurive (vlerën e likuiditeteve gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar), si gjendje dhe jo si kursim.

**17.2.** Pavarësisht sa më lart, duke abstraguuar argumentet mbi mënyrën se si duhen lexuar deklaramet e subjektit mbi gjendjen *cash* të viteve 2004, 2005 e 2006, trupi gjykues, duke konsideruar të mirëqenë pretendimin e Komisionerit Publik për leximin e deklarimeve sipas versionit të logjikës së përdorur prej tij, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit posedonte në fund të vitit 2010, vetëm vlerën prej 1.830.000 lekësh për pagimin e kështit të parë prej 15.000 eurosh [konvertuar në 2.050.000 lekë], në vlerësim të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj shume, do të rezultonte një diferencë negative prej 220.000 lekësh për mbulimin e pagesës së kështit të parë të apartamentit, e cila konsiderohet në një nivel jodomethënës për kualifikimin e situatës faktike sipas nenit 33, pika 5, germa “b”, që do të çonte në zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

18. Në përfundim të vlerësimit të të gjitha shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve të Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, mbështetur në argumentet dhe qëndrimet e mbajtura në arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në fakte e në ligj.

## *II. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

19. *Për procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014*, në të cilin subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, ka qenë në cilësinë e prokurores së çështjes, sipas Komisionerit Publik në ankim, provohet që hetimi penal i ndërmarrë nga subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i plotë dhe paraqet mangësi, pasi nuk rezulton të jetë krahasuar përmbajtja e deklaratës së të dyshuarit me rezultatet e analizave të ekspertimit të ndërmarra në kuadër të këtij hetimi, nga të cilat rezulton mospërputhje dhe në kushtet kur personi i dyshuar ishte person me precedent të mëparshëm penal, subjekti duhet t’u kishte kushtuar vëmendje këtyre rrethanave.

**19.1.** Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, konstaton se dosja e vendimit “Për pushimin e çështjes penale”, datë 29.04.2014, lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 10.03.2014, në ngarkim të shtetasit I. S., për veprën penale “*Prodhim dhe shitje e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, është një nga pesë dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor më datë 28.03.2019, sipas përcaktimit të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në lidhje me këtë procedim penal, në raportin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nuk konstatohen mangësi profesionale.

**19.2.** Lidhur me ecurinë e këtij procedimi penal, nga aktet në dosjen e tij, rezulton se:

**19.2.1.** Referuar informacionit të Oficerit të Policisë Gjyqësore (në vijim “OPGj”) në Seksionin e Luftës kundër Narkotikëve në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, më datë 09.03.2014 është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit I. S., me gjendje gjyqësore i dënuar më parë për veprën penale “*Prodhim dhe shitje të narkotikëve*”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Sipas këtij informacioni, pas një konflikti në familje, në momentin që punonjësit kanë ndërhyrë për të qetësuar gjendjen, kanë vënë re se mbi komodinë kishte një sasi pluhuri në ngjyrë rozë që, për nga karakteristikat, ngjasonte me lëndën narkotike “heroinë”, si dhe tre porcione të mbështjella me letër si ato të shtypit të përditshëm. Gjithashtu, në sirtarin e komodinës është

gjetur një pjatë gjelle me një sasi pluhuri të ngjashme me lëndën narkotike të llojit heroinë. Nga peshimi i lëndës, rezulton se ajo në total kishte një peshë prej 10 gramësh.

**19.2.2.** Nga OPGj-ja, më datë 09.03.2014, janë ndërmarrë disa veprime hetimore: i) është kryer kontrolli i banesës (procesverbal “I kontrollit të banesës ose vendeve të shtetasit I. S.”), ku përveç lëndëve të sekuestruara, nga kontrolli i vijuar në këtë dhomë edhe në dhomat e tjera të katit të dytë të kësaj banese, nuk janë konstatuar sende të tjera të kundërligjshme; ii) është marrë vendim “Për kryerjen e ekspertimit toksikologjik të urinës”; dhe iii) vendimi “Për kryerjen e ekspertimit kimik të lëndës”. Vepra penale referohet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës më datë 10.03.2014.

**19.2.3.** Nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, në cilësinë e prokurores së çështjes, më datë 10.03.2014 nxirret urdhri për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe regjistrimi i emrit të personit nën hetim I. S. Në të njëjtën datë, me “Vendim për vleftësimin e sekuestros”, prokurorja vendos të vleftësojë të ligjshëm sekuestrimin e vendosur mbi sasinë e dyshuar si lëndë narkotike sipas përshkrimit në procesverbalin e sekuestrimit të datës 09.03.2014.

**19.2.4.** Pas kërkesës së subjektit të rivlerësimit, datë 11.03.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 13.03.2014, vendosi të vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të të dyshuarit I. S. dhe të caktojë si masë sigurimi personal “Arrest në burg”.

**19.2.5.** Më datë 13.03.2014, prokurorja nxjerr urdhrin “Për kryerjen e veprimeve hetimore”, duke urdhëruar OPGJ-në për kryerjen e veprimeve hetimore: 1. të merret akti i ekspertimit toksikologjik për lëndën e sekuestruar që dyshohet të jetë e llojit heroinë; 2. të merren fotografitë që kanë shoqëruar kryerjen e veprimeve të ndryshme hetimore; 3. të merret vërtetimi i gjendjes gjyqësore të të dyshuarit dhe certifikatë personale; 4. të kryhet çdo veprim tjetër hetimor që çmohet i nevojshëm për sqarimin e drejtë të rrethanave të faktit; 5. pas kryerjes së veprimeve të mësipërme, të relatohet te prokurori për ecurinë e hetimeve dhe për mënyrën e përfundimit të tyre.

**19.2.6.** Nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë, lëshohet akti toksikologjiko-ligjor nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2014, “Mbi ekspertimin toksikologjik të një mostre urinë në ngarkim të shtetasit I. S., Durrës”. Sipas këtij akti, në mostrën e urinës së shtetasit I. S. u zbulua prania e morfinës monoacetilmorfinë, dhe acetilkodeinës. Ndërsa në aktin nr. {\*\*\*}, datë 11.04.2014, të Drejtorisë së Policisë Shkencore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, analiza për pluhurat objekt ekspertimi tregoi për praninë e paracetamolit dhe kafeinës. Referencat për klasifikimin në lëndë narkotike apo jo gjenden në ligjin nr. 7975 të datës 26.07.1995 për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope.

**19.2.7.** Subjekti i rivlerësimit, më datë 29.04.2014, mbështetur në nenin 328/1, pika “b” e Kodit të Procedurës Penale<sup>17</sup>, merr vendim për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014 për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, në ngarkim të shtetasit I. S., lirim të tij dhe zhdukjen e provave materiale.

**19.2.8.** Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e vendimit për pushimin e procedimit penal, ka parashtruar rrethanat e faktit të ndalimit të të arrestuarit I. S., deklaratimet e tij, faktin për të cilin ishte dënua nga Gjykata e Durrësit në vitin 2010, rezultatet e të dyja akteve, atij toksikologjik nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2014 dhe aktit të ekspertimit kimik të lëndës nr. {\*\*\*}, datë 11.04.2014, me rezultatet respektive të tyre dhe elementet e veprës penale të

<sup>17</sup> Neni 328, pika 1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale: “Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: [...] b. fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”.



parashikuar në nenin 283 të Kodit Penal. Në këtë vendim arsyetohet se *lënda e sekuestruar ka përmbajtje kafeine dhe paracetamol dhe, pavarësisht faktit se dihet që këto dy lëndë përdoren edhe si përzierës për disa lëndë narkotike, personi nën hetim nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi neni 285 kërkon prodhimin apo mbajtjen e substancave kimike apo të tjera, por që duhet të shërbejnë ekskluzivisht për prodhimin e lëndëve narkotike. Në rastin konkret, as kafeina dhe as paracetamoli nuk mund të përdoren për prodhimin e lëndëve narkotike. [...] Për sa më lart, meqenëse mungojnë elementet e veprave penale të parashikuara nga nenet 283 dhe 285 të Kodit Penal, ky procedim penal duhet të pushohet.*

Sipas subjektit në këtë vendim, *klasifikimi i tyre (i referohet substancave kimike apo substancave narkotike dhe psikotrope apo prekursor), i miratuar me ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995, "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", është bërë në bazë të shkallës së rrezikshmërisë për shëndetin që mund të sjellë keqpërdorimi i tyre. Në të gjitha këto klasifikime të renditura në tabela të përpiluara në përputhje me Konventën Unike për Barnat Narkotike të vitit 1961 dhe të Konventës për Lëndët Psikotrope të vitit 1971, nuk pasqyrohet evidentimi i paracetamolit apo kafeinës si lëndë për prodhimin e lëndëve narkotike.*

**19.2.9.** Komisioni, me rezultatet e hetimit administrativ, i kalon barrën e provës subjektit të rivlerësimit për këto tri çështje: *i) subjekti i rivlerësimit nuk e ka krahasuar kurrë përmbajtjen e deklaratës së të dyshuarit me rezultatet e analizës së urinës-kampion që është marrë nga i dyshuari; ii) subjekti i rivlerësimit asnjëherë nuk urdhëroi marrjen në pyetje të të dyshuarit për ta ballafaquar me rezultatin e analizës së urinës (i cili ishte plotësisht në kundërshtim me deklaratën e mëparshme); iii) subjekti i rivlerësimit nuk e hetoi asnjëherë përputhshmërinë midis rezultateve të analizës së urinës dhe substancave që u gjetën në kontrollin e shtëpisë.*

**19.2.10.** Në parashtrimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti deklaroi se lidhur me analizimin e disa të dhënave dhe kryerjen në vazhdim të disa veprimeve të tjera hetimore, në vlerësimin e tij si prokuror nuk do të sillnin asnjë të dhënë të re në lidhje me vlerësimin e ekzistencës së elementeve të veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal apo i ndonjë vepre tjetër penale. Arsyet, sipas tij, për vendosjen e pushimit të procedimit penal, objekti i drejtpërdrejtë i hetimit të çështjes, ka qenë pikërisht fakti se *lënda e dyshuar e gjetur në banesën e shtetasit I. S., nuk ishte narkotike/psikotrope/prekursor, ekzistenca e së cilës si e tillë do të passillte diskutimin për përgjegjësinë penale të të dyshuarit I. S.*

Në vijim të konstatimeve të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, sqaron se gjetja e substancave narkotike në mostrën e urinës së personit nën hetim nuk të çon përpara asnjë forme të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Personi nën hetim vërtet kishte konsumuar substanca narkotike, por këto substanca nuk u gjetën gjendje në banesë për të ngritur diskutimin nëse do të ishim përpara ndonjë forme të anës objektive të kësaj vepre penale. Lënda e gjetur në banesën e tij nuk kishte në përmbajtje substanca të cilat u gjetën në urinën e personit nën hetim dhe as substanca të tjera narkotike. Për këtë arsye, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, të gjitha provat e grumbulluara në lidhje me çështjen penale në fjalë konkludojnë se ishin para një rasti të thjeshtë të konsumimit të lëndëve narkotike nga një person e që, sipas legjislacionit, nuk është ngritur në nivelin e veprës penale, por është rregulluar rasti i mbajtjes së lëndëve narkotike për qëllime të konsumimit në të ardhmen për përdorim vetjak.

**19.3.** Në parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit shpjegon se Komisioneri Publik nuk i referohet asnjë dispozite penale apo procedurale penale të shkelur gjatë hetimit të këtij procedimi penal. Vendimi është i arsyetuar, bazuar në prova e në ligj, referuar edhe në ligjin e posaçëm, çka përmbush në mënyrë shteruese dy aspekte, në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, të përcaktuara shprehimisht në pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

Me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesën e datës 02.06.2021, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, dhe përgjigjen e kësaj të fundit me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.06.2021, me anë të së cilës i vihet në dispozicion kopje e njësuar me origjinalin e procesverbalit (printuar nga sistemi ICMIS) të seancës gjyqësore penale, për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj personit në hetim I. S. Sipas qëndrimit të mbajtur nga pala mbrojtëse e personit nën hetim në këtë seancë gjyqësore, konfirmohet fakti që ky i fundit është *përdorues i lëndës narkotike prej vitesh*.

**19.4.** Fakti që në fashikullin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 10.03.2014, në ngarkim të shtetasit I. S., gjatë veprimeve hetimore janë administruar deklaratimet e I. S. sipas procesverbalit *për pyetjen e të arrestuarit* [mbajtur nga prokurorja Anita Jella më datë 10.03.2014], ku deklarohet se ka *4 muaj që nuk përdor lëndë narkotike. Hera e fundit ka qenë në kohën kur ka humbur babain*, ndërkohë që rezultatet e aktit toksikologjiko-ligjor nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2014, tregojnë se në *mostrën e urinës së shtetasit I. S. u zbulua prania e morfinës monoacetilmorfinë dhe acetilkodeinës*, pra që tregojnë që është përdorues, nuk tregojnë një mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në moskryerjen e ballafaqimit midis deklaratimit dhe të dhënave të ekspertimit, për arsye se subjekti ishte në dijeni që personi nën hetim ishte përdorues i lëndëve narkotike, përpara se të administrohej akti toksikologjiko-ligjor nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2014, pasi ky fakt ishte pohuar nga vëllai i personit në hetim, sipas procesverbalit të mbajtur nga OPGj-ja më datë 09.03.2014, pjesë e materialeve referuar prokurorisë, si dhe gjatë seancës gjyqësore të datës 13.03.2014 për vleftësimin e ligjshëm të arrestit të shtetasit I. S., ku mbrojtësi i tij kishte deklaruar se *i arrestuari ishte përdorues lëndësh narkotike prej vitesh*. Në vlerësim të trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit duket se ka ndërmarrë logjikshëm veprimet hetimore të rrethanave konkrete të pasqyruara në materialin referues të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës dhe ka vlerësuar drejt konkluzionet e dala nga veprimtaria hetimore. Në këtë kuptim, është i paqartë pretendimi i Komisionerit Publik se për çfarë qëllimi dhe në funksion të hetimit të cilës veprimtari të kundërligjshme do të duhej të hetonte më tej subjekti i rivlerësimit.

**19.5.** Në mbështetje të situatës së sipërcituar, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i Komisionerit Publik se për këtë procedim penal, *hetimi penal i subjektit nuk ka qenë i plotë dhe paraqet mangësi*, është i pabazuar në ligj e në prova. Kryerja e veprimit procedural për të krahasuar përmbajtjen e deklaratës së të dyshuarit me rezultatet e analizave të ekspertimit të ndërmarrë në kuadër të këtij hetimi, nuk do të kishte asnjë peshë në veprimet hetimore të kryera apo në konkluzionin e arritur në përfundim të hetimeve.

**19.6.** Për sa më lart, lidhur me këtë procedim penal, nga trupi gjykues nuk u evidentuan mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes. Veprimet hetimore të kryera konsiderohen të plota dhe vendimi i subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283, paragrafi 1 i Kodit Penal, konsiderohet logjik dhe i drejtë në kuptim të indikatorëve të parashikuar nga neni 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për sa kohë lënda e sekuestruar nuk kualifikohet si lëndë narkotike apo psikotrope sipas ligjit nr. 7975, datë 26.07.1995, “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, i ndryshuar. Për rrjedhojë, nuk ka ekzistuar objekti i veprës penale.

**20.** Për procedimet penale të renditura në vijim në këtë vendim, trupi gjykues në kuptim të parashikimit të nenit E, pika 2, fjalia e fundit, e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës, *vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim*, çmon se Komisioni nuk duhet t’ia kishte nënshtruar këto procedime penale, procesit të rivlerësimit, pasi tejkalon kompetencat që i ka dhënë Kushtetuta. Pavarësisht se këto procedime penale duhet t’i nënshtroheshin regjimit

të çështjeve në shqyrtim sipas parashikimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues do t'i trajtojë ato në përgjigje të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik.

21. Komisioni, në vendim arsyeton se në vlerësim të informacioneve të mbledhura gjatë hetimit administrativ lidhur me denoncimet, vlerëson se në asnjë rast nuk u referohen shkeljeve konkrete të bëra nga subjekti në dosjet penale të hetuara prej tij. Denoncimet sipas Komisionit trajtonin çështje që kishin të bënin me pozicionin e tij si drejtues, të cilat në vlerësim me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 97/2016, tregonin sjellje korrekte të subjektit të rivlerësimit në shumicën e rasteve të hetuara. Komisioni, pasi arsyeton mbi ndryshimet kushtetuese dhe ligjore lidhur me pavarësinë e funksionit të prokurorit dhe vendimmarrjes së tij, në raport me kompetencat ligjore të drejtuesve, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka zbatuar ligjin brenda kompetencave si drejtues dhe se mosveprimet e konstatuara në dy raste nuk mund të përbëjnë shkak për vlerësim profesional me mangësi apo të papërshtatshme, referuar nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.
22. Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, Komisioneri Publik pretendon se: i) *ndryshimet e reja ligjore, përfshirë ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk duhen interpretuar në drejtim të mospërgjegjësisë, rolit mbështetës dhe mbikëqyrës të drejtuesit të Prokurorisë, rol të cilin ligji ia njeh me anë të kompetencave udhëzuese dhe me natyrë jodetyruese; ii) subjekti i rivlerësimit, posaçërisht për shkak të detyrës funksionale, kishte të drejtën dhe detyrimin të verifikonte ecurinë dhe përfundimin e çështjes dhe, në rastin konkret, mund të udhëzonte me shkrim kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 97/2016, përpara se prokurori i çështjes të merrte vendimin mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake, trupi gjykues konstaton si vijon.*

22.1. Shqyrtimi i procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019 nga Komisioni, ka ardhur si rezultat i denoncimeve nga portalet mediatike, të cilat ngritën dyshime për qëndrime të ndryshme në shkresat e lëshuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe ndikimin e subjektit të rivlerësimit në pushimin e çështjes dhe asgjësimin e provave, bashkë me prokurorët E. K. dhe N. T., në procedimin penal kundër gjyqtarës Z. S.

22.2. Në kuadër të hetimit administrativ lidhur me këtë procedim penal, pas kërkesës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën {\*\*\*} prot., datë 08.11.2019, dërgon kopje të fashikullit penal me nr. {\*\*\*} të vitit 2019, regjistruar për veprën penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Nga analizimi i akteve të këtij fashikulli, trupi gjykues konstaton si vijon.

22.2.1. Më datë 14.05.2019, shtetasja N. P. depoziton pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, kallëzim penal ndaj shtetasit I. A. për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” dhe ndaj shtetasës Z. S., gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Sipas shtetasës P. në kallëzim, në Gjykatën e Apelit Tiranë po gjykohej çështja civile me palë ndërgjyqëse, paditëse N. P., i paditur I. A. dhe {\*\*\*}, me përmbarues S. H. Pas kërkesës së saj dhe avokates në sekretarinë gjyqësore për t'u njohur me dosjen dhe për të verifikuar nëse kishin dorëzuar të gjithë provat përpara se të zhvillohej seanca gjyqësore, kanë konstatuar se relatorja e çështjes Z. S. në dosje kishte përgatitur dhe printuar vendimin e arsyetuar të çështjes. Ndërsa për të kallëzuarin tjetër, z. I. A., pretendohet se ishte parë nga të afërm të familjes P., në hyrje të hotelit “{\*\*\*}”, si dhe brenda në holl, kafe etj., me z. Th. S., bashkëshortin e relatores, znj. Z. S., gjatë periudhës në pritje të gjykimit. Sipas kallëzimit, Z. S. ka shpërdoruar detyrën, duke kryer veprime, si: *përgatit vendim me shkrim të arsyetuar pa nisur ende shqyrtimi gjyqësor,*

*ndonëse ka papajtueshmëri sepse ka gjykuar në gjykime të tjera në favor të palës së paditur I. A. dhe ka disponuar me vendime që kanë lidhje drejtpërdrejt me çështjen gjyqësore objekt gjykimi dhe këto akte janë të administruara në dosjen gjyqësore, ka shfaqur dyshime serioze e njëanshmëri në lidhje me gjykimin e çështjes.*

**22.2.2.** Nga aktet e fashikullit të këtij procedimi, kallëzimi penal nga shtetasja N. P. është depozituar pranë Prokurorisë për Krime të Rënda në Tiranë, e cila pasi ka kryer disa veprime verifikuese, ka çmuar se veprat penale të referuara nga kallëzuesja, ato të “Ushttrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, i parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, si dhe “Shpërdorimi i detyrës”, i parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, nuk janë kompetencë lëndore e kësaj prokurorie dhe, bazuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 24.05.2019, ka dërguar materialin kallëzues për kompetencë lëndore dhe tokësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Kjo prokurori, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.06.2019, dërgon për kompetencë materialin kallëzues pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për veprat penale të parashikuara nga nenet 245/1 dhe 248 të Kodit Penal, duke qenë se njëri prej personave të kallëzuar ushtron funksionet e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

**22.2.3.** Referuar “Formular mbi dokumentimin e shortit elektronik dhe shpërndarjen e materialeve hetimore të referuara në prokurori, është nënshkruar nga zv./drejtuesi i Prokurorisë A. F.”, pas hedhjes së shortit elektronik, materiali hetimor i është caktuar për ndjekje prokurorit N. T. Prokurori i çështjes, më datë 19.06.2019, urdhëron të regjistrohet procedimi penal nr. {\*\*\*}/2019, për veprën penale të “Ushttrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

**22.2.4.** Në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, shtetasja N. P., më datë 28.06.2019, i drejtohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesë për lëshimin e një vërtetimi nëse ka të regjistruar procedim penal ndaj shtetasës Z. S. për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, si dhe kopje të akteve të hetimeve të deritanishme/paraprake. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 28.06.2019, të nënshkruar nga drejtuesi i seksionit E. K., me urdhër dhe delegim, informon se ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal dhe ky procedim është në fazë hetimi.

**22.2.5.** Pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, është depozituar një kërkesë nga gjyqtare Z. S., e cila pasi është vënë në dijeni nga portali *Dosja.al* dhe nga kërkesa që një palë ka bërë për përjashtimin e saj në një çështje civile, kërkon të informohet nëse në ngarkim të saj është regjistruar ndonjë procedim penal. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2019, të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, konfirmon se nuk ka regjistruar procedim penal ndaj znj. Z. S., me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**22.2.6.** Në përfundim të veprimeve hetimore të kryera, prokurori i çështjes N. T., më datë 09.09.2019, i drejtohet<sup>18</sup> Gjykatës së Rrethit Gjyqësor me kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 19.06.2019, regjistruar për veprën penale “Ushttrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Në këtë kërkesë, ndër të tjera, prokurori arsyeton se është administruar *dokument i pretenduar nga shtetasja N. P., si një vendim i parapërgatitur nga gjyqtarja Z. S. për zgjidhjen e çështjes. [...] Nga këqyrja e këtij dokumenti [...] nuk rezulton se kemi një vendim të parapërgatitur nga gjyqtarja znj. Z. S., për mënyrën e zgjidhjes së kësaj çështjeje. [...] Në këtë dokument nuk gjendet mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe as çfarë ka vendosur apo do të*

<sup>18</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.09.2019, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

vendosë gjykata si vendim për zgjidhjen e çështjes. [...] në këtë dokument gjendet një përmbledhje e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, shkaqet e ankimit dhe apelit kundërshtues dhe një analizë juridike e çështjes, por nuk gjendet zgjidhje e çështjes, siç është pretenduar në kallëzimin e shtetases N. P. Duke u ndodhur para këtij fakti, çmojmë se pretendimet e shtetases N. P. kundër gjyqtarës Z. S. për një vendim gjyqësor të parapërgatitur, që e kishte zgjidhur çështjen pa filluar akoma shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë, nuk janë të vërteta.

**22.2.7.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.10.2019, në çështjen me kërkues Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përfaqësuar nga prokurori N. T., me palë të interesuar, kallëzuese N. P., të kallëzuar Z. S., gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe I. A., me objekt “Kërkesë për pushimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, datë 19.06.2019”, regjistruar për veprën penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, ka vendosur mospranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2019 dhe kthimin e akteve të këtij procedimi për vazhdimin e hetimeve. Kundër këtij vendimi, ushtrohet ankim nga prokurori i çështjes për ndryshimin e vendimit dhe pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019.

**22.3.** Nga ana e Vëzhguesit Ndërkombëtar në këtë çështje, është paraqitur *opinion* me nr. {\*\*\*} prot., datë 14.11.2019, sipas të cilit rezulton se më 16 maj 2019, shtetasja N. P. ka depozituar pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda një kallëzim penal kundër gjyqtarës Z. S. dhe kundër shtetasit I. A. Kallëzimi penal ishte dërguar pranë Prokurorisë Durrës, e cila regjistroi “kallëzim penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019” vetëm kundër z. I. A. Sipas analizës së zhvillimeve të kësaj çështjeje penale, nuk rezulton që të jetë regjistruar apo kryer ndonjë hetim kundër znj. Z. S. Sipas *opinionit* të Vëzhguesit Ndërkombëtar, subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, duhet t’i kalojë barra e provës për të justifikuar mungesën e kontrollit të regjistrimit/hetimit nga Prokuroria e Durrësit, për gjyqtaren Z. S., si rezultat i kallëzimit penal të regjistruar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, dhe më pas transferuar në Prokurorinë e Durrësit.

**22.4.** Në shpjegimet e datës 02.12.2019 mbi rezultatet shitesë të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit sqaron se janë ushtruar kompetencat ligjore për hedhjen në short të materialit kallëzues në mënyrë transparente. Nga zv./drejtuesi i prokurorisë janë caktuar si dispozita për t’u hedhur në short materiali, nenet 248 dhe 245/1 të Kodit të Penal. Ky fakt rezulton nga shënimet e kryera në regjistër dhe hedhja në short e materialit hetimor. Sipas subjektit të rivlerësimit, në momentin kur është vendosur të kërkohet pushimi i çështjes në gjykatë, ligji organik nuk lejonte lënien e udhëzimeve, duke mbrojtur pavarësinë e prokurorit nga ndërhyrjet e drejtuesit të Prokurorisë [neni 43, germa "ç" e ligjit nr. 97/2016]. Drejtuesi, sipas subjektit, mund të udhëzojë prokurorin, por jo pasi ai ka dalë me vendimmarrje dhe në rastin konkret dosja ka qenë e përfunduar dhe është paraqitur vetëm për të firmosur shkresën e dërgimit të saj në gjykatë. Veprimet hetimore dhe mënyra e zgjidhjes së çështjes vlerësohen nga gjyqtari i hetimit paraprak, referuar neneve 329/b dhe 329 të K.Pr.Penale. Në vijim të këtyre parashtrimeve, subjekti sqaron se nga hetimi i kryer, nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë që ngrinte dyshime për kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale prej shtetases Z. S., prandaj nuk është regjistruar si person që i atribuohet vepra penale dhe, si rrjedhim, nuk është kërkuar pushimi i çështjes penale për të, pasi nuk është regjistruar ndonjë çështje penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas nenit 287 të K.Pr.Penale.

**22.5.** Lidhur me ecurinë gjyqësore të kësaj çështjeje penale, subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet, ka depozituar në Kolegj në cilësinë e provës vendimin nr. {\*\*\*}, datë 17.01.2020, me të cilin Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 24.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në këtë vendim, gjykata ka vlerësuar se

vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është marrë në zbatim të drejtë të ligjit në lidhje me dispozitivin, por është pjesërisht i drejtë për veprimet hetimore që duhen kryer. Gjykata arsyeton se pretendimi në ankim i prokurorit, se hetimi është i plotë, është i drejtë dhe duhet pranuar. Megjithëse nga draftvendimi i fotografuar nga kallëzuesja rezulton se arsyetimi është në favor të saj, nuk shpjegohen arsyet pse ajo ka bërë kallëzim kundër gjyqtarës Z. S. Megjithëse kallëzimi i saj nuk ka një arsye për t'u hetuar nga prokurori pa paragjykuar arsyet e kallëzimit, meqenëse krimi i kallëzuar ndiqet kryesisht, ka kryer shumë veprime hetimore të cilat nuk kanë rezultuar se nga të kallëzuarit janë kryer veprime në kundërshtim me ligjin penal. Gjykata e Apelit vlerëson të pabazuar pretendimin në ankim të prokurorit se, pavarësisht se kallëzimi ka pasur si objekt edhe shpërdorimin e detyrës dhe se hetimet janë drejtuar edhe për të, nga ana procedurale nuk ka kryer ndonjë shkelje pse nuk është shprehur edhe për të në kërkesën për pushim [...]. Prokurori nuk ka zbatuar drejt nenin 329/a të K.Pr.P, pasi një mënyrë të tillë disponimi nuk e parashikon ky nen. Prokurori është kontradiktor në disponimin e tij duke identifikuar çështjen me akuzën. Nëse prokurori arrin në përfundimin se të gjitha faktet penale të hetuara prej tij kanë rezultuar të paprovuara, duhet të kërkojë pushimin e çështjes dhe nuk duhet ta identifikojë çështjen me akuzën e “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i K.Penal.

Gjykata e Apelit çmon të drejtë qëndrimin e prokurorit të apelit. Derisa prej prokurorit është kryer një hetim për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, duhet të shprehet proceduralisht edhe për të, pavarësisht se në regjistër nuk është regjistruar si vepër penale.

**22.6.** Pra, nga arsyetimi i Gjykatës së Apelit Durrës, trupit gjykues i rezulton se lënia në fuqi e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 24.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është arsyetuar ndryshe nga kjo gjykatë, e cila nuk ka vlerësuar të nevojshme kryerjen e veprimeve hetimore shtesë, por ka arsyetuar që prokurori i çështjes duhet të kishte kërkuar pushimin në tërësi të çështjes penale dhe për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**22.7.** Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se pas vendimit të sipërcituar të Gjykatës së Apelit Durrës dhe kthimit të akteve të këtij procedimi penal te prokurori, përfundimisht, në fund të procedimit, prokurori kërkoj pushimin në tërësi të çështjes penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 20.09.2020, përsëri ka vendosur mospranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2019 dhe kthimin e akteve për kryerjen e veprimeve hetimore të urdhëruara prej kësaj gjykate në vendimin e mëparshëm nr. {\*\*\*}, datë 24.10.2019, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 17.01.2020.

**22.8.** Pas ankimit të këtij vendimi nga prokurori, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 22.12.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit penal nr. {\*\*\*}, datë 20.09.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe pushimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, datë 19.06.2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në këtë vendim, Gjykata e Apelit Durrës e ka vlerësuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë të pabazuar në ligj dhe në prova. Në pjesën arsyetuese të vendimit, Gjykata e Apelit Durrës, në analizë të tërësisë së akteve hetimore, i gjen të plota veprimet hetimore të organit të akuzës, ndryshe nga sa arsyeton gjykata e shkallës së parë, çështja nuk ka vend për hetime të tjera dhe nuk ka asnjë mundësi drejtimi tjetër të hetimit. Çështja, në kushtet e një hetimi të plotë, siç ka ndodhur në rastin konkret, mbetet tek analiza e të dhënave që japin provat, në raport me kërkesat e ligjit penal material, ku në përfundim të kësaj analize arrihet në konkluzionin se nuk jemi para elementeve të veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Gjykata e Apelit Durrës, në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 17.01.2020, ndryshe nga sa ka disponuar gjykata e shkallës së parë, në pjesën arsyetuese ka vlerësuar të drejtë faktin që përderisa ka një kallëzim penal edhe ndaj

shtetases Z. S., prokurori duhet të kishte dalë me një kërkesë edhe për këtë rast, për këtë shkak do të urdhërohet prokurori që të përpilojë një akt procedural edhe për këtë rast. Pra, e vetmja detyrë që duhet të kryhet nga prokurori sipas vendimit të gjykatës së apelit, është që duhet të shprehet proceduralisht edhe për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Sipas arsyetimit në këtë vendim, Gjykata e Shkallës së Parë nuk i është referuar fare arsyetimit që ka bërë gjykata e apelit, por ka marrë të mirëqenë vetëm pjesën urdhëruese të vendimit dhe në mënyrë të gabuar ka konkluduar se nga prokurori nuk janë kryer detyrat e lëna prej saj. Ndërkohë që gjykata e apelit në vendimin e mëparshëm, qartazi ka arsyetuar dhe konkluduar se hetimet kanë qenë të plota dhe nuk ka vend për kryerjen e asnjë veprimi hetimor që synon marrjen e provave, por vetëm të veprimit procedural të trajtimit në tërësi të çështjes penale duke mos e identifikuar me njërën nga akuzat që ngre kallëzuesi.

Gjykata e Apelit Durrës, ndryshe nga vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë, çmon se nga ana e prokurorisë janë kryer të gjitha detyrat e caktuara nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 17.01.2020. Në vlerësim të gjykatës, është i drejtë konkluzioni i prokurorit që ka kërkuar pushimin e çështjes penale, pasi nga tërësia e këtyre provave del qartë se fakti penal i pretenduar në kallëzim nuk ekziston, dhe faktet e rezultuara në përfundim të hetimit nuk parashikohen nga ligji si vepër penale.

**22.9.** Trupi gjykues çmon të pabazuar pretendimin e Komisionerit Publik se në rastin konkret nuk evidentohet ndonjë komunikim i drejtuesit të prokurorisë me prokurorin e çështjes apo të ketë udhëzuar mbi ecurinë e rastiit, e cila është përgjegjësi e prokurorit por nuk e justifikon mosveprimin si drejtuese e prokurorisë, referuar nenit 43 dhe 48 të ligjit nr. 97/2016, parë në raport me raste të tjera të ngjashme (trajtuar në vijim) ku subjekti, duke shfrytëzuar pikërisht pozitën e drejtueses dhe hapësirat e reja ligjore, si dhe duke ndërmarrë veprime aktive, vendos standard të ndryshëm në ecurinë e çështjes penale. Përcaktimet në nenet 43 dhe 48 të ligjit nr. 97/2016, nuk duhen kuptuar si detyrim i drejtuesit të prokurorisë për të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme për të gjitha procedimet penale të regjistruara, pasi kjo praktikë do të ishte e pamundur si në aspektin kohor, ashtu edhe në aspektin e ushtrimit me efektivitet të kompetencave të tij ligjore. Këto dispozita duhen interpretuar në drejtim të së drejtës dhe diskrecionit që ligji i njeh drejtuesit të prokurorisë për nxjerrjen e këtyre udhëzimeve kur çmohet e nevojshme prej tij, por jo si detyrim ligjor.

**22.10.** Në mbështetje të situatës faktike të evidentuar më sipër, për procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, trupi gjykues nuk konstatoi veprime hetimore konkrete të cilat detyrimisht duheshin kryer prej prokurorit të çështjes, e për të cilat subjekti i rivlerësimit kishte munguar të udhëzonte kryerjen e tyre sipas diskrecionit që ligji i jep drejtuesit të prokurorisë, në këndvështrim të neneve 43 dhe 48 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu ky qëndrim i trupit gjykues vjen në harmoni me konkluzionin e arritur prej Gjykatës së Apelit Durrës në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 22.12.2020. Sipas këtij vendimi të dhënë nga gjykata, si subjekt procedural i ngarkuar nga ligji për ushtrimin e kontrollit mbi veprimtarinë hetimore që kryen prokurori, në funksionin e gjykatës së seancës paraprake, është konkluduar për hetim të plotë të çështjes dhe është pranuar kërkesa për pushimin e saj, duke konfirmuar në këtë mënyrë dhe qëndrimin e subjektit të rivlerësimit, në raport me hetimin e kryer.

- 23.** Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, Komisioneri Publik pretendon se: i) subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës dhe vendimmarrja e Komisionit është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016; ii) veprimet e subjektit të rivlerësimit duhen vlerësuar brenda kriterit të aftësive profesionale, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016 dhe për aq sa gjen zbatim, ligji nr. 96/2016 i ndryshuar;

iii) në vlerësimin e këtij rasti, përtej shpjegimeve të dhëna mbi kompetencën e kufizuar ligjore në cilësinë e drejtueses, duke vepruar pikërisht në këtë cilësi, subjekti ka passjellë një seri ngjarjesh procedurale dhe vonesa të panevojshme, që duket sikur kanë synuar në mbrojtjen e personit nën hetim.

**23.1.** Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se shqyrtimi i procedimit penal nr. {\*\*\*} i vitit 2019 nga Komisioni, ka ardhur si rezultat i dy denoncimeve/ankesave anonime<sup>19</sup> të administruara në Komision, si dhe denoncimeve nga portale mediatike. Në këto denoncime, ngrihen dyshime se zyrtarë të Kadastrës dhe ALUIZNI-t në Durrës (shtetasit A. I., L. K. dhe F. Gj.), të arrestuar së fundmi për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh, kanë fituar lirinë shumë shpejt, pas ndërhyrjes së drejtueses, znj. Anita Jella. Prokurori A. N., sipas këtij informacioni, kërkoi arrestimin e drejtuesit të Kadastrës, z. L. P., por kërkesa drejtuar gjykatës për caktim mase sigurimi “arrest në burg”, u mbajt për rreth 5 ditë nga drejtuesja Anita Jella, pa kryer veprimin administrativ të nënshkrimit të shkresës përcjellëse për në gjykatë, veprime në shkelje të ligjit.

**23.2.** Në aktet e administruara në dosjen gjyqësore për këtë procedim penal, rezulton se procedimi penal nr. {\*\*\*} është regjistruar më datë 22.09.2019, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasës L. K., specialiste juriste pranë Agjencisë së Kadastrës Durrës, ndaluar me urdhër të prokurorit të çështjes dhe me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.09.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është vleftësuar i ligjshëm ndalimi dhe është caktuar masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur përpara oficerit të policisë gjyqësore, si dhe pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, të parashikuar nga nenet 234 dhe 242 të Kodit të Procedurës Penale. Nga ana e prokurorit A. N., më datë 26.09.2019, është hartuar kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” ndaj shtetasit L. P., drejtor i Kadastrës Shtetërore Durrës.

**23.3.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, më datë 30.09.2019, nxjerr “Udhëzim me karakter jo të detyrueshëm në çështjen penale nr. {\*\*\*}, viti 2019”, nëpërmjet të cilit udhëzon prokurorin: 1) *Të regjistrohet emri i autorit L. Z. P., me detyrë drejtor i Kadastrës Shtetërore Durrës.* 2) *Të merren dhe të administrohen akte të tjera hetimore me qëllim që të përmbushet standardi i “dyshimit të arsyeshëm”, me qëllim vendosjen e masës së sigurimit personal.* 3) *Të koordinohet puna edhe me prokurorët e tjerë, të cilët kanë nën hetim procedime penale për punonjësit e AShK-së, me qëllim administrimin e provave të tjera, si dhe mosdëmtimin e hetimeve të këtyre çështjeve të tjera në hetim ose bashkimin e tyre në një procedim penal etj.* Prokurori i çështjes, nëpërmjet shënimit të vendosur mbi këtë udhëzim, i kërkon subjektit të rivlerësimit të respektojë ligjin, të nënshkruajë shkresën përcjellëse, duke i sjellë në vëmendje që punën e tij e vlerëson gjykata, si dhe duke paralajmëruar subjektin se do të bëjë kallëzim penal për shkeljen e ligjit. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nënshkruan shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.09.2019, për dërgimin e kërkesës për caktim mase sigurimi, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, të regjistruar për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në të njëjtën datë, me udhëzimin e subjektit, prokurori i çështjes nxjerr urdhrin “Për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra”, për shtetasin L. P., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**23.4.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 01.10.2019, vendosi caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit L. P. Po kjo gjykatë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.10.2019, vendosi verifikimin dhe konstatimin e respektimit të kushteve dhe kritereve për zbatimin e

<sup>19</sup> Denoncime/ankesa anonime administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 3.10.2019 dhe me nr. {\*\*\*} prot., datë 14.10.2019.



masës shtrënguese “arrest në burg”, dhënë me vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 01.10.2019, dhe vendosi që personi nën hetim L. P. të mbetet me masë shtrënguese “Arrest në burg”.

**23.5.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, pasi u njoh me denoncimet mbi këtë procedim penal, më datë 04.10.2019, shpjegon Komisionin se, lidhur me arrestimin e shtetasit L. P., kërkesa për caktimin e masës së sigurimit është dërguar në zyrën e saj më datë 26.09.2019, ora 15:30, ditë e enjte. Nga rëndësia e faktit, është kërkuar t’i vihen në dispozicion të gjitha materialet hetimore, pasi nga ana e prokurorit nuk i ishin vënë në dijeni, si dhe për faktin se prokurori nuk ishte pjesë e Seksionit të Krimin Ekonomik. Duke qenë e angazhuar në procesin e rivlerësimit, ditën e premte, më datë 27.09.2019, ka autorizuar që materialet t’i kalohen për studim dhe firmosje drejtuesit të Seksionit kundër Krimin Ekonomik, z. E. K. Ky i fundit e ka informuar se seksioni që ai drejton, kishte në hetim dhe dy procedime të tjera penale lidhur me këto fakte dhe persona, për të cilat po kryheshin veprime proaktive dhe veprimet e kryera në një dosje hetimore mund të prishnin veprimet apo provat e procedimeve të tjera dhe duhej bashkëpunim midis prokurorëve të këtyre çështjeve për të rakorduar procedimet penale. Subjekti i rivlerësimit shprehet se, duke mos pasur asnjë problem lidhur me afatet për dorëzimin e kësaj kërkesë, në kuptim të Kodit të Procedurës Penale vendosi të zhvillonte një mbledhje me prokurorët ditën e hënë. Meqë prokurori i çështjes nuk ishte paraqitur, subjekti kishte hartuar një udhëzim me karakter jodetyrues, i cili nuk u mor parasysh nga prokurori dhe nga ana e subjektit të rivlerësimit u firmos shkresa përcjellëse drejtuar gjykatës.

**23.6.** Nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 06.11.2019, Vëzhguesi Ndërkombëtar i paraqet një gjetje Komisionit, për vonesën që i atribuohet znj. Anita Jella në ndjekjen e procedurës si drejtuese e prokurorisë në procedimin nr. {\*\*\*}, duke parashtruar se: *1. Nuk provohet që, më datë 26 shtator 2019, kjo mbledhje ishte arsyeja për shtyrjen e depozitimit të kërkesës për arrestim të përgatitur nga prokurori i çështjes A. N., ose që mbledhja është mbajtur. 2. Veç kësaj, fakti që vendimi i gjykatës nr. {\*\*\*} i datës 1 tetor 2019, ka caktuar masën e arrestit me burg në bazë të kërkesës së prokurorit, pra pa hetim shtesë të kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, me udhëzimin e saj “jurdhërues”, është provë që provon se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për prokurorin e çështjes ishte e panevojshme në këtë pikë; ky konkluzion konfirmohet më tej nga vendimi i gjykatës nr. {\*\*\*}, datë 4 tetor 2019, referuar edhe në shtojcat e kësaj gjetjeje. 3. E fundit, por jo nga rëndësia, është evidente që ishte e mundshme që të kërkohej regjistrimi i emrit të L. P. në regjistrin përkatës të prokurorisë që në datën 26 (të enjten) ose 27 (të premten) shtator 2019, pa prituri për të hënë, 30 shtator 2019.*

**23.7.** Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet e-mail-it të datës 10.11.2019, i përgjigjet Komisionit për pyetjen mbi arsyet e mbledhjes në lidhje me çështjen nr. {\*\*\*}/2019, ditën e hënë, datë 30.09.2019, arsyet e këtij takimi, personat që kanë qenë të pranishëm në të, si dhe vënien në dispozicion të procesverbalit të kësaj mbledhjeje. Sipas subjektit të rivlerësimit, arsyet e takimit më datë 30.09.2019 ishin për t’u informuar dhe rakorduar punën në prokurori, me qëllim mosdëmtimin e procedimit penal, i cili ndiqej me veprime proaktive nga prokurori A. Sh. në lidhje me Kadastrën e Durrësit. Prokurori A. N., i cili kishte njoftim për takimin, nuk ishte paraqitur dhe pa dhënë arsye për mosparaqitjen. Pas informacionit me shkrim, nga prokurori A. Sh. dhe S. B., dhe diskutimit me z. E. K. (Drejtues i Seksionit të Hetimit të Krimin Ekonomiko-Financiar dhe Kibernetik), është vijuar me përpilimin e një udhëzimi me karakter jodetyrues, i cili i është komunikuar prokurorit të çështjes. Udhëzimi nuk është marrë në konsideratë prej tij dhe më pas është nënshkruar menjëherë shkresa përcjellëse duke dërguar materialin në gjykatë. Takimi nuk u arrit të bëhej. Sa i përket procesverbalit të mbledhjes, subjekti sqaron se për këto takime nuk mbahet procesverbal, por pas diskutimeve nëse drejtuesi çmon se duhet të dalë me udhëzim me karakter jodetyrues e përpilon dhe ia njofton prokurorit të çështjes, si në këtë rast. Procesverbal, sipas subjektit, mbahet për mbledhjet e përgjithshme të prokurorëve, që organizohen nga drejtuesi i Prokurorisë/ose kur kërkohet nga një e treta e

prokurorëve, sipas parashikimeve të nenit 56, pika 3<sup>20</sup> e ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

**23.8.** Mbi ecurinë e masës së sigurimit personal, pas ankimit të ushtruar nga personi nën hetim dhe mbrojtja e tij, Gjykata e Apelit Durrës<sup>21</sup>, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.10.2019, vendosi ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 01.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që kishte caktuar masën e sigurimit “Arrest në burg” ndaj shtetasit L. P. dhe vendimit nr. {\*\*\*}, datë 04.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që ka vendosur vazhdimin e zbatimit të kësaj mase sigurimi dhe caktimin e masës së sigurimit të “Detyrimit për t’u paraqitur para policisë gjyqësore” ndaj personit nën hetim L. P. Gjykata e Apelit Durrës vlerëson se niveli i dyshimeve dhe gjendja e rrezikut nuk është e pranishme në atë shkallë e rëndësi që të bëjë të zbatueshme masën e sigurimit “arrest në burg”, pasi nuk rezulton një shkallë rrezikshmërie e theksuar shoqërore e personit nën hetim L. P. dhe vlerëson se masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, është e përshtatshme me nivelin e të dhënave në ngarkim dhe që nuk do të pengonte hetimin e plotë, objektiv e të shpejtë të çështjes.

**23.9.** Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2019, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet mbi rezultatet e hetimit, sqaron se prokurori A. N. ka qenë në ditën e gatishmërisë kur ka shkuar një denoncim anonim drejtpërdrejt atij, ky denoncim sipas subjektit të rivlerësimit *nuk ka kaluar nga sekretaria, nuk i është nënshtruar shortit elektronik, nuk është sigluar nga drejtuesi apo shefi i seksionit dhe pse vepra penale nuk i përkiste seksionit ku bënte pjesë, ku për çdo seksion ka prokurorë të gatshëm në çdo ditë të muajit*. Prokurori N., sipas subjektit, është angazhuar vetë për të kryer veprime hetimore dhe ka nxjerrë dy urdhra ndalimi për shtetasit L. K. dhe F. Gj. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, ka konkluduar të procedonte me caktim mase sigurimi dhe ndaj shtetasit L. P., ndërkohë që nga ana e prokurorit tjetër A. Sh. po zhvilloheshin hetime proaktive në procedimin penal nr. {\*\*\*}/2019, për veprat penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal, ndaj shumë personave. Subjekti sqaron se ndaj shtetasit L. K. po zhvilloheshin veprime proaktive në kuadër të një procedimi tjetër, ndërkohë që nga prokurori A. N. u nxor një urdhër ndalimi për të. Sipas subjektit në parashtrime, vonesa në nënshkrimin e kërkesës për masën e sigurimit ndaj shtetasit L. P., nuk ka sjellë asnjë pasojë për çështjen që ndiqte prokurori A. N., pasi personi nën hetim është arrestuar në zyrën e tij, ndërkohë që për shkak të moskryerjes në kohë të disa veprimeve hetimore në kuadër të procedimit {\*\*\*}/2019, u shty në kohë arrestimi i 27 personave të hetuar në mënyrë proaktive, përfshirë dhe punonjës të Zyrës së Kadastrës Durrës, fakt i bërë publik dhe në media.

**23.10.** Në parashtrimet e depozituara në Kolegj ndaj shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës, disa akte procedurale që provojnë ecurinë gjyqësore të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2019, si vijojnë.

**23.10.1.** Në përfundim të hetimit që i përket procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve L. K. dhe L. P., prokurori i çështjes më datë 22.09.2020, i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me *kërkesë për pushimin e çështjes* që i përket procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019 dhe shuarjen e masave të sigurimit personal ndaj të dyshuarve.

**23.10.2.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2020, ka vendosur: 1) *miratimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës*; 2) *pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 22.09.2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës” që parashikohet nga neni 248 i Kodit Penal, ndaj shtetasve L. P. dhe L. K.*; 3) *shuarjen e masave të sigurimit “Detyrim për t’u*

<sup>20</sup> Neni 56, pika 3 e ligjit nr. 97/2016, parashikon: “3. Për të gjitha mbledhjet e prokurorëve mbahet procesverbal i përmbledhur me shkrim”.

<sup>21</sup> Gjykata e Apelit Durrës, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.11.2019 “Dërgim vendimi gjyqësor”.

*paraqitur në Policinë Gjyqësore”- Durrës, të vendosura ndaj shtetasve L. P. e L. K. në zbatim të nenit 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale. [...]. Vendim i cili ka marrë formë të prerë më datë 28.12.2020.*

**23.11.** Me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti dhe informacionin e datës 03.12.2021 të prokurorit A. Sh. “Për procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 13.03.2019”. Referuar këtij informacioni, në bazë të kallëzimit të Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, datë 13.03.2019, për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili më pas është bashkuar me procedime penale të tjera, duke mbajtur këtë numër. Në funksion të hetimit për këtë procedim penal, *janë aplikuar hetime proaktive nëpërmjet përgjimit telefonik të disa specialistëve pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, përfituesve dhe posedues të pasurive objekt hetimi, sipas vendimeve nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, {\*\*\*}, {\*\*\*}, {\*\*\*}, {\*\*\*}, {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, datë 19.09.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. [...]. Nga data 19-22 shtator 2019, bazuar në kërkesën tonë nr. {\*\*\*}, datë 18.09.2021, i është kërkuar gjykatës aplikimi i metodave proaktive të lejimit të përgjimit të disa punonjësve në detyrë në Zyrën Vendore të Kadastrës Durrës, si L. K., A. Gj. dhe A. I. Kërkesa jonë është vlerësuar nga gjykata me vendimin e saj nr {\*\*\*}, datë 19.09.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, duke lejuar përgjimin telefonik për të gjithë shtetasit e përshkruar në kërkesë.*

**23.12.** Më datë 22.10.2019, prokurori i çështjes i drejton Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për shtetasit A. I., A. K., B. Z., R. Z., M. D., R. P., D. K., E. N., M. Z., L. O., S. I., Gj. B., E. Sh., L. M., L. B., A. R., Gj. P., A. D., L. N., L. B., si caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për shtetasit Gj. B., A. Ç., Sh. A., D. G., S. M., A. Th., L. K. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.10.2019, ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për caktimin e masës së sigurimit për shtetasit e përmendur më sipër në kërkesën e prokurorit. Sipas informacionit të datës 03.12.2021 të prokurorit A. Sh., hetimi për këtë procedim penal ka përfunduar dhe kjo çështje është duke u gjykuar në seancë paraprake me objekt, kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.

**23.13.** Në këto kushte, për procedimin penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2019, trupi gjykues konstaton se fakti që mbledhja e caktuar për ditën e hënë, datë 30.09.2019, nuk është kryer, pranohet dhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, duke shpjeguar se shkak për këtë ka qenë fakti se prokurori N. ka refuzuar të marrë pjesë në këtë mbledhje. Megjithëse udhëzimi me karakter jodetyrues i subjektit të rivlerësimit, nuk është pranuar nga prokurori i çështjes, përsëri ka prodhuar pasoja, siç rezulton nga regjistrimi i emrit të L. P. në regjistër nga prokurori i çështjes, në të njëjtën datë me këtë udhëzim, konkretisht më 30.09.2019. Për këtë procedim penal, trupi gjykues nuk konstatoi mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të kohës së përcjelljes në gjykatë të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, duke qenë se ligji procedural penal nuk parashikon një afat të caktuar për këtë veprim dhe koha e marrë prej subjektit të rivlerësimit për kryerjen e tij nuk konsiderohet si një kohë e paarsyeshme në drejtim të vlerësimit të situatës dhe ushtrimit të diskrecionit për nxjerrje ose jo të ndonjë akti në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë. Referuar akteve të dosjes dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, shkresa përcjellëse e përpiluar nga prokurori A. N., mban datën 26.09.2019 dhe është depozituar në zyrën e drejtueses rreth orës 15:30 të kësaj date, ndërkohë që e nesërmja ka koiciduar me ditë të premtë, që rezulton dhe e vetmja ditë pa veprime procedurale, dhe që pavarësisht faktit që subjekti nuk ndodhet në kushtet e një shkeljeje procedurale për efekt të afatit të nënshkrimit të shkresës, përsëri kjo shkresë rezulton të jetë mbajtur pa nënshkruar vetëm një ditë pune [ditën e premtë datë 27.09.2019] pasi, siç rezulton, ditën e hënë është dërguar në gjykatë. Mbi të gjitha, elementi i paraqitur në *gjetjen* e vëzhguesit ndërkombëtar, sipas së cilës gjykata ka mbështetur qëndrimin e prokurorit të çështjes, trupi gjykues konstaton se në finale të këtij

procesi gjyqësor, ky qëndrim i prokurorit ka rezultuar i pambështetur, përderisa gjykata ka konkluduar mbi pathemelshmërinë e akuzave dhe kërkesave për masa shtrënguese. Gjithashtu, edhe mungesa e nevojës së zhvillimit të mbledhjes, sipas *gjetjes*, nuk provohet, përderisa provohet pretendimi i subjektit të rivlerësimit për ekzistencën e procedimit tjetër penal, me nr. {\*\*\*}/2019, të regjistruar mbi aktivitetin e disa punonjësve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, për të cilin kanë përfunduar hetimet dhe po zhvillohet gjykimi.

**23.14.** Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi aktet gjyqësore që lidhen me këtë procedim penal, për të cilin subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë kishte udhëzuar koordinimin mes prokurorëve, si dhe ecurinë e një procedimi tjetër penal, vlerësoi të drejta dhe të bazuara në ligj argumentet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në udhëzimin me karakter jo të detyrueshëm, të nxjerrë në zbatim të nenit 43, germa “ç” dhe nenit 48 të ligjit nr. 97/2016, lidhur me këtë çështje. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka sjellë vonesa procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e për më tepër, nën optikën e zgjidhjes së çështjes nga kontrolli gjyqësor nga Gjykata e Apelit Durrës, duket se ndërhyrja e tij ka qenë proporcionale e në zbatim të drejtë të rolit drejtues. Ecuria e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2019 dhe vendimi i gjykatës për pushimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit L. P. tregon se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në logjikë të ligjit, pa synuar mbrojtjen e personit nën hetim.

- 24.** Lidhur me çështjen e mungesës së koordinimit dhe ekzistencës së një sistemi efektiv dhe eficient të regjistrimit dhe shpërndarjes së procedimeve penale, konstatuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në muajin gusht të vitit 2019, Komisioneri Publik ka pretenduar se: i) Subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet dhe provat e paraqitura, nuk arriti të provonte të kundërtën për sa i është kaluar barrë prove. ii) Nga kronologjia e ecurisë së veprimeve procedurale të ndërmarra gjatë muajit gusht, bie në sy mungesa e organizimit të një sistemi efektiv dhe eficient që, më së paku, ka vënë në rrezik cilësinë dhe rezultatet për procedimet penale aktive. Është fakt se në këtë situatë, rasti është trajtuar nga tre prokurorë të ndryshëm, të cilët kanë kryer veprime procedurale të ndryshme, e në disa raste të paregjistruara. iii) Përfshirja e tre prokurorëve të ndryshëm në fazat fillestare të hetimit, edhe pse bëhet fjalë për muajin gusht, nuk tregon menaxhim të duhur të burimeve të institucionit dhe sistemit të gatishmërisë, pasi modalitete të tilla mund të çojnë përfundimisht në dëmtim të vetë hetimit. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve të dosjes për këtë çështje, konstaton:

**24.1.** Kjo çështje është sjellë në vëmendje të Komisionit nga denoncime anonime<sup>22</sup>, si dhe denoncime nga portalet mediatike. Sipas këtyre denoncimeve, Anita Jella ka ndikuar në lirimin e A. I. dhe disa punonjësve të tjerë të ALUIZNI-t që kishin legalizuar një kasolle në breg të detit, fakt i bërë publik në media. Subjekti i rivlerësimit, sipas denoncimeve, mbylli dosjen e korrupsion-falsifikimeve të A. I., duke ia hequr dosjen prokurorit S. N. e duke ia dhënë pa short, prokurorit N. T., i cili e nxori të pastër e në liri. Në gusht 2019, prokurori A. N. nisi një hetim mbi drejtuesit e lartë të ALUIZNI-t dhe Kadastrës në qytetin bregdetar, ku në vijim të veprimeve procedurale, urdhëroi ndalimin e A. I., L. K., si dhe u shpall në kërkim ish-drejtori i ALUIZNI-t, F. Gj. Referuar denoncimeve, asnjë prej këtyre zyrtarëve nuk është pas hekurave, pasi me firmën e Jellës, akuza në gjykatë u përfaqësua nga të tjerë prokurorë, të cilët kërkuan lirimin e tyre.

**24.2.** Në kuadër të denoncimeve të depozituara, Komisioni i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 08.10.2019, duke kërkuar ndër të tjera, kopje të procedimeve penale në ngarkim të shtetasve F. Gj. dhe A. I., për legalizimet kur

<sup>22</sup> Administruar në Komision me nr. {\*\*\*}, datë 03.10.2019 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 14.10.2019.

kanë qenë drejtues të ALUIZNI-t Durrës. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.10.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, informon se për sa u përket procedimeve penale në ngarkim të shtetasit F. Gj. etj., rezulton se më datë 15.02.2018 është regjistruar procedimi nr. {\*\*\*} i vitit 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në lidhje me dyshimet për legalizim të objekteve pa leje, në kundërshtim me ligjin, për kohën që drejtonte zyrën e ALUIZNI-t Durrës. Ky procedim është bashkuar edhe me disa procedime të tjera dhe aktualisht është në hetim dhe hetohet nga prokurorja E. P.

**24.3.** Ndërsa lidhur me shtetasin A. I., sipas kësaj shkrese, është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, i vitit 2019, i cili hetohet nga prokurori N. T.. Në përgjigjet e datës 10.11.2019, e pyetur nga Komisioni, në lidhje me shtetasin A. I. dhe vendimin për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, S. N., me prokurorin N. T., subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella shpjegoi se gjatë muajit gusht, konkretisht më datë 09.08.2019, prokurori A. N. ka qenë i gatshëm dhe mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit F. M., ka kryer veprime hetimore dhe ka nxjerrë urdhra ndalimi për pesë shtetas, pa regjistruar procedim penal, si dhe pa shkresë përcjellëse të Prokurorisë, nga të cilat në momentet e para janë ekzekutuar vetëm dy prej tyre. Më 11.08.2019, datë në të cilën ka qenë i gatshëm prokurori S. N. sipas grafikut të gatishmërisë, është vijuar me regjistrimin e procedimit penal dhe përpilimin e kërkesave<sup>23</sup> për vleftësimin e ndalimeve të kryera dhe caktimin e masave të sigurimit për katër të ndaluar. Në vijim, më datë 28.08.2019, ka qenë i gatshëm prokurori N. T., nga policia gjyqësore është ekzekutuar një urdhër ndalimi i nxjerrë që në fillim të gushtit, në kuadër të këtij procedimi penal, dhe për këtë shkak është kërkuar vleftësimi i ndalimit dhe caktimi i masës së sigurimit personal nga ky prokuror.

Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu shpjegon se më datë 12.09.2019 prokurori S. N., pjesë e Seksionit të Krimit të Përgjithshëm, ka paraqitur kërkesën për zëvendësimin e tij, pasi procedimi penal ishte regjistruar për veprat penale të cilat ndiqeshin nga Seksioni i Krimit Ekonomik dhe zëvendësimi i prokurorit S. N. me prokuror N. T. u vendos pasi nga ky i fundit kishte trajtuar një ndalim, pra një veprim urgjent. Prokurori A. N., sipas subjektit, bënte pjesë në seksionin e Krimit të Përgjithshëm sipas urdhrat nr. {\*\*\*}, datë 31.07.2019. Të tre prokurorët kishin kryer veprime urgjente gjatë muajit gusht, prokurori A. N. kishte nxjerrë urdhrat e ndalimit, prokurori S. N. ka regjistruar procedimin penal dhe ka kërkuar vleftësimin e ndalimeve dhe caktimin e masave të sigurimit për disa prej të ndaluarve, prokurori N. T. ka trajtuar kërkesën për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masave të sigurimit për një të ndaluar, veprime të kryera në kuadër të këtij procedimi penal. Rregulli që zbatohet në këto raste, ashtu siç veprohet në të gjitha prokuroritë dhe gjykatat e vendit, është respektuar edhe në zëvendësimin e prokurorit të këtij procedimi penal, duke caktuar njërin nga prokurorët që kishte trajtuar veprime urgjente të dosjes, që njihte dosjen dhe bënte pjesë në Seksionin e Krimit Ekonomik.

**24.4.** Vëzhguesi Ndërkombëtar ka paraqitur *opinion*, me nr. {\*\*\*} prot., datë 14.11.2019, sipas të cilit përfshirja e tre prokurorëve të ndryshëm në fazat fillestare të hetimit, edhe pse bëhet fjalë për muajin gusht, nuk tregon menaxhim të duhur të burimeve të institucionit dhe të sistemit të gatishmërisë, pasi modalitete si ato të ndodhura në çështjen konkrete mund të çojnë përfundimisht në dëmtim të vetë hetimit, duke shprehur mendimin që subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, t'i kalohet barra e provës për të provuar ekzistencën e organizimit efektiv dhe eficient të punës, në gusht 2019, në Prokurorinë e Rrethit Durrës dhe Komisioni, në bazë të dispozitave të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, duhet të kërkojë marrjen e provave.

**24.5.** Në parashtrimet e dhëna mbi rezultatet shitesë të hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit sqaron se ka vepruar në mënyrë korrekte duke mos i sjellë asnjë dëm

---

<sup>23</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 11.08.2019 dhe shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 13.08.2019, mbi dërgimin e kërkesave për vleftësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit në ngarkim të shtetasit R. K., më datë 11.08.2019, dhe në ngarkim të shtetasve A. I., F. R. dhe Xh. N., më datë 13.08.2019.

çështjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2019, çështje e cila është duke u hetuar nga një prokuror që i përket seksionit që merret me hetimin e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Caktimi i këtij prokurori është në përputhje me parimin e “organit kompetent të ngarkuar me ligj”, i shërben hetimit sa më eficient dhe profesional të çështjes, pasi ai gëzon njohuri të posaçme lidhur me hetimin e veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi, si prokuror i seksionit të Krimin Ekonomik.

Në vijim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit sqaron se sa i përket mënyrës së organizimit të gatishmërisë në muajin gusht, ka marrë masa për të siguruar mirëfunksionimin e prokurorisë me qëllim trajtimin në kohë të çdo veprimi procedural të ngutshëm dhe ndjekjen e këtyre veprimeve në gjykatë. Ndarja e periudhës së gatishmërisë së prokurorëve në muajin gusht 2019, është bërë në përputhje me nenin 23, pika 5 e ligjit nr. 96/2016 dhe periudha e gatishmërisë ka qenë e ndarë me ditë konkrete. Në mbledhjen e përgjithshme të mbajtur në fund të muajit korrik, është diskutuar lidhur me grafikun dhe më datë 31.07.2019, varianti përfundimtar i grafikut të gatishmërisë, me dakordësinë e plotë të prokurorëve, i cili u është njoftuar prokurorëve, OPGj-ve, punonjësve të tjerë të prokurorisë, Drejtorisë së Policisë, Komisariateve dhe një kopje Prokurorisë së Përgjithshme. Në këtë kuadër, natyra e veprimeve procedurale të kryera nga 3 prokurorët në periudhën e gatishmërisë nuk mund të ndikojë negativisht në ecurinë e hetimeve, kur të gjitha këto veprime kanë të bëjnë me vlerësimin e ndalimeve dhe caktimin e masave të sigurimit.

**24.6.** Përfshirja e tre prokurorëve në çështjen nr. {\*\*\*} të vitit 2019, sipas subjektit, është shkaktuar nga disa urdhra ndalimi që prokurori A. N. kishte nxjerrë për disa persona në periudhën e tij të gatishmërisë në muajin gusht, ku një urdhër është ekzekutuar menjëherë, ndërkohë që edhe pse ekzekutimi i urdhrin të ndalimit është bërë ditën që po ky prokuror ka qenë vetë i gatshëm, nuk është bërë prej tij kërkesa për vlefhtësimin e ndalimit në gjykatë. Veprimet procedurale në vijim janë kryer nga prokurorët e gatshëm S. N. dhe më pas N. T., të cilat janë fokusuar në realizimin e veprimeve urgjente, në përputhje të plotë me detyrimet ligjore sipas grafikut të gatishmërisë që realizohet vetëm në muajin gusht. Sipas subjektit të rivlerësimit, ka qenë prokurori A. N. që ka treguar mungesë të vullnetit për të vazhduar hetimet në çështjen në fjalë, pasi edhe pse e dinte që kishte lëshuar urdhër-ndalimet të cilat priteshin të ekzekutoheshin, ka mbyllur telefonin si mënyrë komunikimi për t’u njoftuar për mënyrën se si do të procedohej më tej. Në këto kushte, ndërhyrja e prokurorit S. N. ka qenë e domosdoshme për të proceduar brenda afateve ligjore dhe më pas aktet i kanë kaluar prokurorit N. T.

**24.7.** Nga aktet shkresore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet në Kolegj, rezulton se më datë 09.08.2019, në prokurori është paraqitur shtetasi F. M., i cili ka bërë kallëzim penal në lidhje me legalizimin e një prone dhe konkretisht të një strukture ndërtimeve njëkatëshe, në lagjen nr. {\*\*\*}, {\*\*\*} Durrës, në kundërshtim me ligjin e legalizimit. Prokurori S. N., më datë 11.08.2019, ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, ndaj shtetasve A. I., F. R., R. K. dhe për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, ndaj shtetasve Xh. N. dhe E. S.

Më datë 13.08.2019, po i njëjti prokuror, i drejton Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kërkesën “Për vlefhtësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasve nën hetim A. I., F. R. dhe Xh. N.”, nëpërmjet së cilës, për këta shtetas, përveç vlefhtësimit të ligjshëm të ndalimit të tyre nga policia gjyqësore e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, është kërkuar dhe caktimi i masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Kërkesë e cila pranohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.08.2019.

Në vijim, më datë 29.08.2019, me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përfaqësuar nga prokuror N. T., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 29.08.2019, vendosi vleftësimin e ligjshëm të ndalimit të datës 27.08.2019, të personit nën hetim E. S., për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe caktimin e masës së sigurisë “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

**24.8.** Sa i përket ecurisë gjyqësore<sup>24</sup> të procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 11.08.2019, nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, rezulton se në përfundim të hetimit, prokurori i çështjes N. T. i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesë për:

1. Dërgimin në gjyq të çështjes nr. {\*\*\*} të vitit 2019, me të pandehur shtetasit: i) A. M., akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; ii) E. R., akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal; iii) A. D., akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; iv) A. S., akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.

2. Pushimin e çështjes në lidhje me personat nën hetim: i) A. I., për veprën penale të parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal; ii) F. R., për veprën penale të parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal; iii) R. K., për veprën penale të parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal; iv) Xh. N., për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal; v) E. S., për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, nëpërmjet vendimeve të saj nr. {\*\*\*}, datë 07.06.2021, dhe nr. {\*\*\*}, datë 06.12.2021 ka pranuar kërkesat e prokurorit të çështjes për këtë procedim penal.

Referuar informacionit nr. {\*\*\*} prot., datë 07.12.2021, të prokurorit N. T. drejtuar drejtueses Anita Jella, pas kërkesës së kësaj të fundit në kuadër të procesit të rivlerësimit, çështja penale në ngarkim të të pandehurve A. M., E. R., A. D. dhe A. S., pasi është pranuar kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim, si dhe kërkesa e të pandehurve për të proceduar me gjykim të shkurtuar, kjo çështje gjendet në fazën e konkluzioneve përfundimtare.

**24.9.** Me parashtrimet para Kolegjit, subjekti shprehet se zëvendësimi i prokurorëve në hetimin e çështjeve penale është praktikë e njohur, dhe ndodh për arsye të ndryshme që lidhen me rrethana objektive. Kjo nuk duhet konsideruar se sjell domosdoshmërisht dëmtimin e hetimeve. Gjithashtu ka çështje komplekse ku për një hetim më të specializuar, formohen grupe hetimore me disa prokurorë që ndjekin një çështje të caktuar, që do të thotë se pjesëmarrja e disa prokurorëve në hetimin e një çështjeje penale, nuk e dëmton atë, por përkundrazi mund të

---

<sup>24</sup> 1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.06.2021, vendosi:

- të pranojë kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për dërgimin në gjyq të procedimit penal me nr. {\*\*\*}, të vitit 2019, ndaj të pandehurve A. M., E. R., A. D. dhe A. S.

- të pranojë kërkesën e prokurorisë për pushimin e çështjes penale për personat në hetim, A. I., F. R. dhe Xh. N.;

- kthimin e akteve prokurorit, me qëllim thellimin e hetimeve në drejtimit e përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit, brenda një afati 2-mujor nga komunikimi i këtij vendimi, për personat nën hetim, E. S. dhe R. K.

2. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim prokurori i çështjes, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 7.06.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2019, edhe për dy personat nën hetim E. S. dhe R. K. Gjykata e Apelit Durrës, me anë të vendimit të saj nr. {\*\*\*}, ka vendosur mospranimin e apelit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

3. Pas kryerjes së veprimeve hetimore të përcaktuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.06.2021, prokurori më datë 09.11.2021 ka paraqitur kërkesë “Për pushimin e çështjes”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, në ngarkim të shtetasve R. K. dhe E. S. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.12.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe të pushojë procedimin penal {\*\*\*} të vitit 2019, në ngarkim të shtetasve R. K. dhe E. S.

shërbejë për një hetim më efikas të saj. Sipas subjektit në parashtrime, përfshirja e tre prokurorëve në këtë çështje, nuk ka ardhur si rezultat i menaxhimit joeficient të burimeve të prokurorisë, apo urdhrave të nxjerrë për organizimin e grafikut të gatishmërisë dhe koordinimit të punës në muajin gusht, por përkundrazi, kjo gjendje është shkaktuar pikërisht nga mosrespektimi i urdhrave dhe udhëzimeve të nxjerra për menaxhimin e punës në këtë rast.

**24.10.** Në kuadër të organizimit të punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, subjekti, përveç akteve të depozituara në Komision që lidhen me mbarëvajtjen e punës gjatë periudhës së gatishmërisë për muajin gusht, për vitet 2018 dhe 2019, me parashtrimet në Kolegj ka depozituar dhe akte të tjera, si urdhra dhe grafikë për shpërndarjen e çështjeve dhe mbarëvajtjen e punës për muajin gusht, si për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, ashtu dhe për administratën e prokurorisë, së bashku me grafikët e gatishmërisë gjatë lejes vjetore në këtë muaj, për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Po kështu, në mbështetje të parashtrimeve, subjekti ka depozituar dhe akte të tjera shkresore për miratimin e periudhës së lejes vjetore dhe gatishmërisë, lidhur me praktikat e ndjekura nga disa prokurori të tjera, si ato pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Tiranë dhe Shkodër.

**24.11.** Lidhur me organizimin dhe koordinimin e punës për muajin gusht, nga trupi gjykues nuk u konstatuan mangësi profesionale të kryera prej subjektit të rivlerësimit përgjatë organizimit të punës për këtë periudhë, të cilat do të afektonin indikatorin e parashikuar nga neni 80, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nëpërmjet urdhrave përkatës, subjekti i rivlerësimit ka arritur të vendosë rregulla që përcaktojnë detyrat dhe mënyrën e funksionimit të prokurorisë përgjatë muajit gusht 2019. Sa i përket shërbimit të gatishmërisë gjatë muajit gusht të vitit 2019, nëpërmjet urdhrit nr. {\*\*\*} prot., datë 31.07.2019, të subjektit të rivlerësimit “Për miratimin e lejeve vjetore dhe mbarëvajtjen e punës në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për muajin gusht të vitit 2019”, në pikën 6, është përcaktuar se *prokurorët e planifikuar në shërbim gatishmërie, kryejnë veprime përkatëse për ditët e gatishmërisë dhe ndjekin në vazhdimësi të gjitha veprimet e ngutshme dhe të nevojshme për procedimet e regjistruara në periudhën e gatishmërisë së tyre, pavarësisht përfundimit të gatishmërisë. [...] Për sa u përket masave të sigurimit të vendosura në mungesë, prokurorët, nëse e vlerësojnë dhe janë të pamundur për të ndjekur procesin e ekzekutimit të masave të sigurimit, të bëjnë fotokopje të akteve përkatëse dhe t'i dorëzojnë te Drejtuesit e Seksioneve, sipas gatishmërisë, të cilët marrin masa për zbatimin e nenit 248 të K.Pr.Penale.*

Trupi gjykues vëren se për vetë specifikën e organizimit të punës në muajin gusht, trajtimi i çështjeve nga prokurorë të ndryshëm në këtë periudhë, ndodh si përjashtim nga rregulli mbi të cilin funksionon prokuroria, por në respektim dhe ekuilibër me të drejtën e prokurorëve për lejen vjetore dhe kryerjen e funksioneve prokuroriale, pa dëmtuar ecurinë e hetimeve edhe duke respektuar në të njëjtën kohë të drejtat e njeriut. Synimi i rregullave të vendosura në këtë kontekst, është mundësia e kryerjes së veprimeve procedurale të ngutshme në mungesë të qenies efektive në punë të trupës së prokurorëve dhe me qëllimin që të ketë përgjigje nga çdo zyrë drejt ushtrimit të ndjekjes penale me efektivitet. Zbatimi i këtyre rregullave nuk zgjidh shpërndarjen e çështjeve penale sipas seksioneve apo organizimit të brendshëm dhe as nuk përcakton definitivisht prokurorin që do të trajtojë çështjen, por vetëm përcakton prokurorët që do të duhet të kryejnë veprimtari të ngutshme në ditë të caktuara të muajit gusht.

**24.12.** Përfundimisht, lidhur me çështjen e *mungesës së koordinimit dhe ekzistencës së një sistemi efektiv dhe eficient të regjistrimit dhe shpërndarjes së procedimeve penale, konstatuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në muajin gusht të vitit 2019*, trupi gjykues vlerëson se përfshirja e tre prokurorëve të ndryshëm në fazat fillestare të hetimit të procedimit penal nuk tregon mangësi në menaxhimin e burimeve të institucionit dhe sistemit



të gatishmërisë, dhe aq më pak në dëmtim të veprimtarisë hetimore, pasi prej të tre prokurorëve janë kryer veprime procedurale të tilla, si urdhër regjistrimi, urdhra ndalimi, si dhe kërkesa për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit, pra veprime të cilat duhet të kryhen brenda një afati të caktuar me pasojë legjitimimin e tyre, si parashikuar nga nenet 258 e 259 të Kodit të Procedurës Penale, ngutshmëri e cila ka përcaktuar edhe pjesëmarrjen e tyre në procedim sipas grafikut të gatishmërisë.

*Lidhur me shqyrtimin e denoncimeve të paraqitura në Kolegj*

25. Në kuadër të denoncimeve nga publiku të depozituara në Kolegj, vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në seancën e datës 20.12.2021, nga subjekti i rivlerësimit u paraqiten parashtrime, si dhe aktet shkresore në mbështetje të tyre, të administruara nga Kolegji në cilësinë e provës. Komisioneri Publik, pas parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit mbi denoncimet, gjatë seancës gjyqësore u shpreh se denoncimet nuk përmbajnë fakte apo rrethana të cilat duhet t'i parashtrijë, përgjigjet e subjektit të rivlerësimit janë të kënaqshme dhe këto denoncime nuk kanë nevojë për trajtim të mëtejshëm. Gjatë kësaj seance Komisioneri Publik depozitoi një qëndrim me shkrim sipas së cilit parashtrimet e subjektit dhe aktet bashkëlidhur tyre nuk paraqesin rrethana të ndryshme nga sa është hetuar dhe dokumentuar nga Komisioni dhe parashtruar nga Komisioneri Publik në shkaqet e ankimit, të cilat vlerësohen të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë.

Në seancën gjyqësore të datës 27.01.2022, trupi gjykues, pasi shqyrtoi denoncimet dhe rrethanat e tyre, përfshirë dhe denoncimin e depozituar rishtas gjatë shqyrtimit të çështjes, dhe administroi në cilësinë e provës aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të hetojë më tej lidhur me denoncimin e regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2021, duke mos hetuar më tej për denoncimet e tjera.

26. Lidhur me *denoncimin e regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2021*, nga denoncues anonim, sipas të cilit Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është e korrupsionuar lidhur me veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal që përmban dënim deri në 1 vit burgim. Prokurorë të korrupsionuar e pushojnë procedimin penal pa iu drejtuar me kërkesë gjykatës për pushim, duke qenë se vepra parashikon 1 vit burg, e konsiderojnë si një kundërvajtje penale, ndërkohë që sipas nenit 1 të Kodit Penal është vetë dispozita që bën dallimin nëse kemi të bëjmë me një kundërvajtje penale apo krim. Përderisa dispozita nuk e ka bërë një përcaktim të tillë, ajo konsiderohet krim dhe, bazuar në nenin 329/a, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, kur procedohet për krime, prokurori bën kërkesë për pushim në gjykatë. Denoncuesi pretendon se drejtuesja e Prokurorisë, znj. Anita Jella, dhe zëvendësi E. K. kanë heshtur për përfitime të tyre.

26.1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, në parashtrimet për këtë denoncim sqaron se pushimi nga prokurorët i çështjeve për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, nuk është diktuar nga qëndrimet e saj si drejtuese, por kjo praktikë është përcaktuar nga qëndrimet e Gjykatës së Apelit Durrës në çështjet e trajtuara prej saj. Në vitin 2018, kjo gjykatë ka mbajtur qëndrim se për veprat penale të cilat parashikojnë dënim deri në dy vjet burgim, është në kompetencën e prokurorit të vendosë në lidhje me pushimin e procedimit dhe ka nxjerrë jashtë juridiksionit të saj trajtimin e tyre. Kjo praktikë ndiqet edhe nga prokuroritë e tjerë që ka në juridiksion kjo gjykatë. Për mbajtjen e këtij qëndrimi, subjekti sqaron se janë orientuar edhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 30.10.2018, e cila njofton prokurorët e Prokurorisë së

Rrethit Gjyqësor Durrës me vendime të Gjykatës së Apelit Durrës, për të evituar qëndrimet e ndryshme në raste analoge.

**26.2.** Në mbështetje të parashtrimeve, subjekti depozitoi shkresën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, drejtuar subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, në cilësinë e drejtueses, me lëndë: “Mbi gjykimin e çështjes me objekt pushimin e procedimit penal”, me anë të së cilës sjell në vëmendje dy vendimet e Gjykatës së Apelit Durrës nr. {\*\*\*}, datë 03.10.2018 dhe nr. {\*\*\*}, datë 25.10.2018, që lidhen me veprat penale të “Dhunës në familje” dhe “Ndërtimit të paligjshëm”, të parashikuara nga nenet 130/a/1 dhe 199/a/1 të Kodit Penal. Në zbatim të nenit 328/1 të Kodit të Procedurës Penale, sipas kësaj shkrese, është e drejta e prokurorit që në përfundim të hetimit paraparak të vendosë pushimin e procedimit penal apo akuzës për kundërvajtje penale. Në disa dispozita të pjesës së posaçme të Kodit Penal, për vepra penale me maksimum dënimi deri në dy vjet burgim, parashikohet shprehimisht se është kundërvajtje penale dhe në disa dispozita të tjera, ky term nuk përdoret. Sipas kësaj shkrese, në nenin 32/2 të Kodit Penal, bëhet përcaktim i qartë i veprave penale në kundërvajtje penale dhe krime dhe se kriter i përcaktuar nga ligjvënësi, është maksimumi i dënimit, që për kundërvajtjet është deri në dy vjet burgim, pavarësisht përkufizimit të bërë në nenin 1/2 të Kodit Penal.

Sipas parashtrimeve të subjektit, prokurorët në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës kanë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me këtë çështje, dhe subjekti në cilësinë e drejtuesit nuk ka kompetencë për t’i diktuar qëndrimin që duhet të mbajnë, për sa kohë kjo është një praktikë e vendosur nga gjykata, por edhe në respektim të bindjes së brendshme dhe pavarësisht së prokurorëve që kanë hetuar çështjen. Në cilësinë e drejtueses së prokurorisë, subjekti ka nënshkruar shkresat për dërgimin në gjykatë të kërkesave për pushimin e çështjes.

**26.3.** Në kuadër të hetimit të mëtejshëm për këtë denoncim, Kolegji kërkoi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës të dhëna lidhur me numrin e çështjeve penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, që lidhen me veprën penale të parashikuar nga neni 199/a, paragrafi i parë i Kodit Penal dhe vendimet përkatëse të marra për këto çështje për periudhën kohore 2018-2021. Në përgjigjen e Prokurorisë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 01.02.2022, Kolegji informohet se për periudhën e kërkuar, rezulton të jetë hetuar nga subjekti i rivlerësimit vetëm procedimi penal nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2017, ku në përfundim të hetimeve, është dërguar me kërkesën për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës më datë 06.02.2018.

**26.4.** Trupi gjykues, në vlerësim të këtij denoncimi, parashtrimeve dhe akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes, evidenton mangësi në ushtrimin e rolit drejtues të subjektit të rivlerësimit, i cili, në zbatim të nenit 42, germa “d” e ligjit nr. 97/2016, që përcakton detyrën e drejtuesit të prokurorisë për të organizuar diskutime për çështje të natyrës profesionale, duhej të kishte ndërmarrë hapa me anë të të cilëve të orientohej një qëndrim i saktë ligjor dhe i unifikuar në prokurorinë që drejton, lidhur me zbatimin e nenit 1, paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe kualifikimin e duhur të veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a, paragrafi i parë i Kodit Penal. Megjithatë, në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, mangësia e konstatuar nuk u vlerësua prej trupit gjykues se mund të afektojë vlerësimin e këtij kriteri në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 96/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016.

**27.** Lidhur me *denoncimin e regjistruar në Kolegji me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.05.2021*, nga denoncues anonim, sipas së cilit Anita Jella dhe Y. P. kanë shpërdoruar detyrën me fondet publike duke paguar bashkëshortin e znj. A. M., z. E. Ç., pa u paraqitur dhe pa punuar asnjë ditë që nga momenti që A. M. u bë Prokuror e Përkohshme. Sa i përket pjesës së denoncimit që i adresohet subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, sipas denoncuesit në korrik të vitit 2019, A. M. komandon burrin e saj Oficer të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Durrës dhe

nga muaji korrik deri në dhjetor 2019, ai nuk ka kryer asnjë punë në Prokurorinë e Durrësit dhe megjithatë është paguar rregullisht. Drejtuesja Anita Jella ka bërë raporte pune për E. Ç., duke i konfirmuar Prokurorisë së Rrethit Shkodër se ai ka punuar rregullisht dhe duhet paguar në mënyrë të plotë nga struktura ku kishte emërimin, pra nga Shkodra. Sipas denoncuesit, gjatë kësaj periudhe, z. E. Ç. ka pasur në ngarkim vetëm dy procedime penale dhe ato nuk i mbaroi, duke i mbartur nga viti në vit. Kjo shifër gjendet në raportin e Prokurorisë së Durrësit për vitin 2019, që u publikua fillimisht edhe në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme, por vetëm disa ditë pasi u publikua, ky raport u zhduk dhe u publikua një tjetër, me shifra ndryshe vetëm për z. E. Ç. Sipas denoncuesit, drejtuesja e Prokurorisë Durrës, znj. Anita Jella, jo vetëm që e ka favorizuar atë, duke e paguar pa kryer asnjë punë, duke i sjellë dëm ekonomik institucionit, por nga ana tjetër edhe ka falsifikuar të dhënat zyrtare, të përgatitura nga vetë ajo.

**27.1.** Subjekti i rivlerësimit pasi u njoh me këtë denoncim, parashtroi se të dhënat në të, për favorizim të oficerit të policisë gjyqësore (në vijim “OPGj”) E. Ç., paraqesin rrethana të rreme dhe nuk qëndrojnë. Sipas informacionit të përgatitur nga zyra e regjistrimit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, rezultoi se ky oficer ka pasur ngarkesë që nga viti 2019 e në vazhdim. Subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës së datës 20.11.2021, depozitoi akte të përpiluara nga OPGj-ja në kuadër të veprimeve hetimore të kryera për procedimeve penale, të cilat sipas subjektit, rrëzojnë tërësisht aludimet e ngritura në denoncim. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur parashtrimeve të datës 20.12.2021, rezultoi se OPGj E. Ç., në vitin 2019 ka trajtuar 22 çështje dhe ka mbartur 21 në vitin 2020; në vitin 2020 ka trajtuar 61 çështje dhe ka mbartur në vitin tjetër 37; në vitin 2021 ka trajtuar 137 çështje, prej të cilave 47 i ka mbartur në vitin tjetër.

**27.2.** Nga analizimi i akteve shkresore të depozituara në Kolegj, rezultoi se OPGj E. Ç. ka qenë i ngarkuar nga prokurorja e çështjes E. P. për të kryer veprime hetimore që u përkasin procedimeve penale nr. {\*\*\*}, datë 16.09.2019; nr. {\*\*\*}, datë 21.10.2019; nr. {\*\*\*}, datë 21.10.2019; nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2019; nr. {\*\*\*}, datë 10.10.2019; nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2019. Në kuadër të veprimtarisë hetimore të OPGj-së, nga subjekti i rivlerësimit janë vënë në dispozicion të Kolegjit disa akte të përpiluara prej tij, si pesë procesverbale [për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, si dhe për sekuestrimin e provave materiale], shtatë shkresa dhe tre urdhra për thirrje të shtetasit, të kryera në kuadër të procedimeve penale nr. {\*\*\*}/2019, {\*\*\*}/2019 dhe {\*\*\*}/2019.

**27.3.** Trupi gjykues, duke pasur në konsideratë faktin që sipas denoncimit, OPGj E. Ç. është emëruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në korrik 2019, si dhe faktin që veprimet hetimore i janë ngarkuar nga prokurorja e çështjes/çështjeve, nuk konstatoi nga hetimi gjyqësor elemente të cilët mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në drejtim të organizimit e shpërndarjes së ngarkesës së punës së oficerit të policisë gjyqësore E. Ç. Nga të dhënat që ofrojnë aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se OPGj-ja ka qenë i ngarkuar me punë dhe i përfshirë në veprimtari hetimore, ndryshe nga sa pretendon denoncuesi. Përcaktimi i masës apo vlerësimi mbi drejtësinë dhe barazinë e ngarkesës së punës së këtij oficeri në raport me oficerët e tjerë të zyrës, është një analizë të cilën Kolegji nuk mund ta kryejë brenda kuadrit të këtij procesi, sepse të dhënat e administruara nuk japin informacion mbi çdo element që do të mundësonte një analizë të tillë dhe do të prodhonte një konkluzion të drejtë mbi atë që synohej të kuptohej. Ajo që dukshëm rezultoi nga të dhënat e që vlerësohet me interes në kuadër të këtij procesi, është se pretendimi i pasqyruar në denoncimin e përmendur, se OPGj-ja nuk ka hetuar asnjë dosje, nuk rezultoi të jetë i vërtetë e, për pasojë, nuk mund të afektojë vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit.

28. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se vlerësimi si më lart, kryhet brenda dhe vetëm për qëllime të procesit të rivlerësimit, pa afektuar vlerësimet e mundshme të subjektit të rivlerësimit nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, sipas kompetencës përkatëse.
29. Në përfundim të sa më sipër, pas shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit dhe të hetimit të denoncimeve, Kolegji arriti në përfundimin se qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi dhe në legjislacionin e zbatueshëm.
30. Kolegji, në përfundim, çmon se vendimi nr. 221, datë 10.12.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, për pasojë ai duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 221, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Anita Jella.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.02.2022.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi - kundër*

#### **RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi - kundër*

#### **KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores, kam mbajtur qëndrim kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për çështjen (JR) nr. 13, datë 01.06.2020, mbi ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 221, datë 10.12.2019, të Komisionit Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella.
2. E kundërshtoj vendimin e marrë nga shumica e trupit gjykues për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit nr. 221, datë 10.12.2019, pasi çmoj se në shqyrtimin e çështjes në Komision, ashtu dhe në Kolegj, nuk janë vlerësuar drejt rrethanat e fakteve në përputhje me provat e administruara në dosje, rrjedhojë e konstatimit të gjendjes faktike në mënyrë jo të plotë dhe të pasaktë, me pasojë zgjidhjen jo të drejtë të çështjes. Për sa më sipër, arsyetoj:

### *i. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë*

- Për pasurinë *apartament banimi, me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen nr. {\*\*\*}, rruga {\*\*\*}, nr. {\*\*\*}, kati i {\*\*\*}, Durrës*
3. Sipas ankimit të Komisionerit Publik, mbështetur në rekomandimin e ONM-së, *pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mosdeklarimin e përdorimit të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup> për vitet 2011 – 2016, nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe janë në kundërshtim me faktet e dala nga hetimi administrativ. Sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, parashikohet qartë objekti i deklarimit ku konkretisht në pikën 1, germa “a” përcaktohet se duhen deklaruar pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to. Ndryshimi ligjor i mëpasshëm i vitit 2017, në të cilin bazohet subjekti, ka bërë vetëm një saktësim, ku është shtuar togfjalëshi sipas Kodit Civil, pa ndryshuar asgjë në thelbin e detyrimit për deklarim. Referuar dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, posedimi bën pjesë në të drejtat reale e për të cilat, në kontekstin e detyrimit ligjor të deklarimit të pasurisë, përbënte detyrim për t’u zbatuar nga subjekti i rivlerësimit për vitet 2011-2016, përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 84/2016 dhe plotësimi i deklaratës “vetting”.*

**3.1.** Në vlerësimin tim, pretendimi i Komisionerit Publik është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe në prova, pasi nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, duke treguar kështu tendencë për të paraqitur në mënyrë të pasaktë, pasuritë në pronësi apo përdorim, si dhe burimin e krijimit të tyre.

**3.2.** E kundërshtoj shumicën e trupit gjykues lidhur me këtë shkak ankimi për sa i përket qasjes së subjektit të rivlerësimit për dy apartamentet e banimit, përkatësisht 97 m<sup>2</sup> i porositur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, si deklaruar prej tij në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, dhe apartamentin me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*.

**3.3.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, e pyetur nga Komisioni në pyetësin standard: *Nëse ka përdorur shtatë vitet e fundit pasuri të regjistruara në emër të dikujt tjetër [...] – deklaroi se nga dhjetori i vitit 2011, kemi përdorur apartamentin e ndodhur në lagjen nr. {\*\*\*}, rruga “{\*\*\*}”, pallati nr. {\*\*\*}, Durrës, apartament në të cilin banoj aktualisht, i cili që nga muaji mars i vitit 2010, ka qenë i porositur pranë shoqërisë sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK, nga vëllai i bashkëshortit, A. Sh. Ndër të tjera, subjekti deklaroi se, pasi jemi akomoduar në këtë banesë me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, kunati im A. Sh. hoqi dorë nga blerja e këtij apartamenti dhe bashkëshorti me subjektin e rivlerësimit hoqën dorë nga apartamenti i porositur me sipërfaqe 97 m<sup>2</sup>, në vitin 2011.*

Sa i takon deklarinimit më sipër të subjektit të rivlerësimit, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore, nuk rezulton i provuar fakti i anulimit/revokimit të kontratës së sipërmarrjes mes A. Sh. dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për apartamentin 113 m<sup>2</sup>, njëkohësisht as revokim i kontratës së sipërmarrjes mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit E. Sh. dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për apartamentin 97 m<sup>2</sup>.

**3.4.** Për pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me apartamentin në posedim, me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, kam evidentuar sa vijon:

- në deklaratën e pasurisë *vetting*, si burim krijimi për apartamentin me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, deklarohet kursime të bashkëshortes në vite nga paga si prokurore në shumën 2.500.000 lekë dhe kredi në shumën 5.650.000 lekë, financuar kredimarrësit E. Sh. dhe subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, në cilësinë e dorëzantës, nga Banka Kombëtare Tregtare, Agjencia Peqin ShA, me kontratë kredie bankare nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 10.11.2011, me objekt *blerje shtëpie*, që korrespondon me apartamentin me sipërfaqe 97 m<sup>2</sup>, porositur nga bashkëshorti E. Sh. me kontratë sipërmarrjeje nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 26.08.2011.

- Sa i takon apartamentit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka rezultuar që ky apartament të jetë porositur pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, fillimisht nga kunati i subjektit të rivlerësimit, z. A. Sh., me kontratë sipërmarrjeje nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 17.03.2010. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, rezulton që për likuidimin e këstit të dytë të këtij apartamenti, shtetasi A. Sh. është financuar në shumën 5.000.000 lekë nga Banka Kombëtare Tregtare ShA, Dega Elbasan, sipas kontratës së kredisë bankare nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 01.06.2010. Nga kjo shumë e financuar, 4.070.000 lekë shërbyen për pagesën e këstit të dytë të çmimit të këtij apartamenti.

Pra, ndërsa apartamentin me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup> subjekti i rivlerësimit e deklarohet në pronësi në deklaratën e pasurisë *vetting*, kunati i tij vijon të paguajë këstet e kredisë së marrë nga BKT ShA për këtë apartament, ndërsa b/shorti i subjektit dhe vetë subjekti vijnë të paguajnë këstet e kredisë së marrë për apartamentin e banimit që korrespondon me apartamentin me sipërfaqe 97 m<sup>2</sup> të porositur nga E. Sh. në vitin 2011, prej të cilit pretendojnë se kanë hequr dorë.

- Nga analizimi i deklaratave të interesave privatë, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar përdorimin/posedimin e apartamentit me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, të porositur nga kunati A. Sh., ku pretendon të ketë banuar prej muajit dhjetor të vitit 2011 deri në vitin 2016 [tetor 2016 me nënshkrimin e deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 08.10.2016], ndërkohë që gjatë hetimit administrativ në Komision, ka deklaruar se [...] ka kryer edhe investim për ta përshtatur për banim, në vlerën 450.000 lekë, me burim nga kursimet nga pagat.

- Nga shqyrtimi i deklaratave të interesave privatë 2009-2011, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar adresë banimi lagjia “{\*\*\*}”, Peqin, ndërsa në deklaratat e interesave privatë 2012-2015, ka deklaruar si adresë rr. “{\*\*\*}”, lagjia nr. {\*\*\*}, Durrës. E pyetur në Kolegj nga relatorja e çështjes se përse nuk ka deklaruar adresën e saktë të banimit, subjekti ka pretenduar se meqë dy apartamentet ndodhen në të njëjtin pallat, ka deklaruar adresën e pallatit rr. “{\*\*\*}”, lagjia nr. {\*\*\*}, Durrës, pasi kështu e ka çmuar, pa saktësuar katin e banimit dhe numrin e apartamentit ku banonte. Mosdeklarimi i elementeve të mësipërme, ngre dyshimin se ka tendencë për të krijuar paqartësi për identifikimin e apartamentit të cilin e ka poseduar realisht.

- I vetmi akt që përcakton këmbimin e dy apartamenteve sipas subjektit është deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 08.10.2016, mes administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}”

ShPK, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit E. Sh., dhe vëllait të tij, kunatit të subjektit të rivlerësimit A. Sh., ku është shprehur dakordësi e palëve që bashkëshorti i subjektit E. Sh., në këmbim të heqjes dorë nga apartamenti 97 m<sup>2</sup>, porositur me kontratë sipërmarrje nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 26.08.2011, të përfitojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet për apartamentin 113 m<sup>2</sup>.

Në analizim të sa më sipër konstatuar, unë gjyqtare në pakicë vlerësoj të drejtë pretendimin e ngritur në ankim nga Komisioneri Publik lidhur me mosdeklarimin nga subjekti i rivlerësimit të përdorimit të këtij apartamenti për periudhën 2011-2016, në zbatim të përcaktimit të nenit 4, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

Në përfundim, lidhur me mosdeklarimin nga subjekti për posedimin e apartamentit 113 m<sup>2</sup>, në kushtet kur nga personi i lidhur E. Sh. [bashkëshorti] është nënshkruar *kontratë sipërmarrjeje me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.08.2011*, për apartamentin me sipërfaqe ndërtimi 97 m<sup>2</sup>, në çmimin 67.900 euro dhe posedimin nga subjekti i rivlerësimit që prej fillimit [dhjetor 2011] të apartamentit të porositur nga kunati A. Sh. me *kontratë sipërmarrjeje ndërtimi nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.03.2010*, sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, në vlerën 71.190 euro, vlerësoj se subjekti kishte detyrimin ligjor të saktësonte në deklaratat periodike marrëdhënien respektive me këto dy apartamente, një të porositur më datë 26.08.2011 nga bashkëshorti i subjektit dhe një në posedim, porositur nga A. Sh. më datë 17.03.2010, *të cilin ka filluar ta posedojë nga dhjetori i vitit 2011, duke kryer edhe investim për ta përshtatur për banim. Gjithashtu vlen të theksohet se këto dy apartamente ishin të lidhura me të njëjtën shoqëri ndërtimi, ndodheshin në të njëjtin pallat, njëri në katin e dytë dhe tjetri në katin e katërt. Pra, brenda vitit 2011, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit porosit një apartament me sipërfaqe 97 m<sup>2</sup> dhe në dhjetor të këtij viti, subjekti i rivlerësimit posedon një apartament tjetër, në të njëjtin pallat, me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, në emër të kunatit të saj, të padeklaruar deri në vitin 2016.*

Në kuptim të nenit “D”, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”*, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë saktë në deklaratën periodike dhe atë të pasurisë *vetting* situatën faktike të përdorimit dhe të shkëmbimit të apartamentit me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, në vlerën 71.190 euro, si dhe heqjen dorë nga apartamenti me sipërfaqe 97 m<sup>2</sup>, në vlerën 67.900 euro, i ndodhur në katin e dytë, i porositur fillimisht nga bashkëshorti i subjektit.

4. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se *subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, kursimet në deklaratat periodike vjetore. Në përputhje me nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, shuma aritmetike e kursimeve në cash deri në fund të vitit 2010, rezulton 1.830.000 lekë, e cila nuk përputhet me shumën e pretenduar nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision, prej 2.200.000 lekësh dhe as me shumën e deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, prej 2.500.000 lekësh, për pagesën e kështit të parë të apartamentit, prej 15.000 eurosh, me të ardhurat e kursyera ndër vite:*

4.1. Unë, gjyqtare në pakicë, çmoj se është i drejtë konstatimi i Komisionerit Publik sa u takon deklarimeve kontradiktore të kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë të pretenduara si burim për likuidimin e kështit të parë të apartamentit 97 m<sup>2</sup>, të ndryshme nga sa deklarohet në deklaratën e pasurisë *vetting*, apo pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet për rezultatet e hetimit administrativ në Komision.

4.2. Unë kam një qëndrim ndryshe nga shumica e trupit gjykues sa i përket verifikimit të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të krijuar kursimet

në *cash* me të ardhura nga burime të ligjshme, të deklaruara në deklaratat e interesave privatë, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e kështit të parë prej 15.000 eurosh, më 26.08.2011, ditën e nënshkrimit të *kontratës së sipërmarrjes* nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., mes palës investitore shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe porositësit E. Sh.

4.3. Ndryshe nga shumica, e cila vlerëson mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit duke u kufizuar vetëm në versionin e pretenduar nga Komisioneri Publik në ankim që lidhet vetëm me mënyrën e leximit të deklaratave periodike sa u takon kursimeve në *cash* të deklaruara ndër vite, unë, gjyqtare në pakicë, vlerësoj se Kolegji, si një nga institucionet e rivlerësimit, ka detyrimin dhe kapacitetin nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, të verifikojë mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të krijuar këto kursime në *cash*, mbi bazën e një analize të mirëfilltë ekonomiko-financiare dhe të konkludojë në bazë të rezultatit të gjetur.

5. Me këtë arsyetim, u krye analiza financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për pagimin e kështit të parë prej 15.000 eurosh [konvertuar në 2.050.000 lekë], në datën e lidhjes së kontratës së porosisë 26.08.2011, duke verifikuar fillimisht mundësinë e krijimit të kursimeve në *cash* të deklaruara në deklaratat e interesave privatë për çdo vit, dhe të pretenduara nga subjekti për periudhën 2004 - 2009. Rezultatet e analizës treguan mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 637.895 lekë, për likuidimin e kështit të parë, më datë 26.08.2011. Rezultatet e analizës financiare të kryer duke konsideruar kursime ndër vite në vlerën 2.500.000 lekë, si deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, që kanë shërbyer si burim për pagesën e kështit të parë të apartamentit, tregojnë mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 723.283 lekë.

**Ndodhur në këto kushte, pasaktësia në deklaram e shoqëruar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme sipas parashikimit në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, tregon që subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, e në këto kushte ndaj tij duhet të ishte aplikuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.**

6. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për moskonsiderimin e kunatit A. Sh. si person tjetër të lidhur (ndërkohë që Komisioni e ka konsideruar person tjetër të lidhur në vendim dhe subjekti nuk e ka kundërshtuar këtë cilësim të tij), në kushtet kur: i) subjekti i rivlerësimit e ka përdorur apartamentin me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup> për periudhën dhjetor 2011 – 2016 [tetor], thajse pesë vjetë pa shpërbllim, apartamenti i porositur nga kunati A. Sh. në mars të vitit 2010, për të cilin ishte likuiduar shuma 65.000 euro deri më 20.10.2010, sipas përcaktimeve në kontratën e sipërmarrjes; ii) subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga shkëmbimi i pretenduar, por i paprovuar me dokumentacion, sipërfaqe më të madhe banimi [113 m<sup>2</sup> nga 97 m<sup>2</sup>], si dhe diferencën në çmim në vlerën 3.290 euro [71.190 euro për apartamentin 113 m<sup>2</sup> kundrejt 67.900 euro apartamenti 97 m<sup>2</sup>], ndërkohë që në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.10.2016, si akt i vetëm i administruar për këmbimin e apartamentit, nuk ka gjetur reflektim sa pretenduar lidhur me diferencën në çmim, çmuj se, nisur nga rrethanat më sipër, z. A. Sh. duhet të ishte klasifikuar person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ngarkohej me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtij apartamenti. Me të dhënat e dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore, verifikuam mundësinë financiare të kunatit të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar me të ardhura nga burime të ligjshme likuidimin e shumës 65.000 euro në vitin 2010 [sipas kësteve të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes]. Rezultatet e analizës financiare treguan pamjaftueshmëri të të ardhurave të ligjshme të z. A. Sh. dhe personit/personave të lidhur për të justifikuar likuidimin e kësaj shume në vitin 2010.



7. Për sa sipër arsyetuar, në kushtet e i) mosdeklarimit të përdorimit të apartamentit me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup> për vitet 2011 – 2016; ii) mungesës së dokumentacionit provues për shlyerjen e kësteve nga z. A. Sh. te shoqëria ndërtimore e më pas kthimin e shumës së paguar nga shoqëria tek ai; iii) mungesën e një kontrate revokimi që të ligjërojë shkëputjen e marrëdhënies juridike të z. A. Sh. me apartamentin 113 m<sup>2</sup>, pasi deklarata noteriale nuk është akti provues që do të formalizonte përfitimin e pronësisë mbi këtë apartament; iv) faktit që kreditë bankare vijnë të paguhet për të dyja apartamentet si nga z. E. Sh. për apartamentin 97 m<sup>2</sup> dhe z. A. Sh. për apartamentin 113 m<sup>2</sup>; v) edhe pse pretendohet kthimi i shumës së paguar, z. A. Sh. nuk rezulton të ketë përdorur këtë shumë për likuidimin qoftë edhe pjesor të kredisë së tij, vi) së fundmi, pamjaftueshmëria e subjektit të rivlerësimit dhe e personit të lidhur për pagesën e këstit të parë prej 15.000 eurosh, si dhe pamjaftueshmëria e burimeve financiare të z. A. Sh. për pagesën e kësteve të apartamentit 113 m<sup>2</sup>, më krijon bindjen se ndodhemi në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, që çon në zbatimin e nenit 61, pika 3 e këtij ligji për deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit.

Për më tepër, në dritën e fakteve të përmendura më sipër, më krijohet bindja se ekzistojnë indicie, për tentativë të subjektit për fshehje të pasurisë apartament, me sipërfaqe 97 m<sup>2</sup>.

#### *ii. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

8. Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014, ndryshe nga arsyetimi i shumicës [paragrafët 19.4 – 19.6], që vlerëson se pretendimi i Komisionerit Publik është i pabazuar në ligj e në prova dhe se nuk u evidentuan mangësi profesionale të subjektit në cilësinë e prokurorit të çështjes, në vlerësimin tim:

Në kushtet kur në fashikullin e procedimit penal, në ngarkim të shtetasit I. S., gjatë veprimeve hetimore janë administruar deklaratimet e I. S. sipas procesverbalit *për pyetjen e të arrestuarit* [mbajtur nga prokurorja Anita Jella më datë 10.03.2014] se ka 4 muaj që nuk përdor lëndë narkotike. *Hera e fundit ka qenë në kohën kur ka humbur babain*, ndërkohë që rezultatet e aktit toksikologjiko-ligjor nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2014, treguan se në mostrën e urinës së shtetasit I. S. u zbulua prania e morfinës monoacetilmorfinë, dhe acetilkodeinës, pra që provojnë që është përdorues, fakt ky i pohuar nga vëllai i personit nën hetim sipas procesverbalit të mbajtur nga OPGj-ja më datë 09.03.2014, dhe nga mbrojtësi i personit nën hetim gjatë seancës gjyqësore për vleftësimin e ligjshëm të arrestit të këtij shtetasi, në prani të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella. Në vlerësimin tim, edhe pse akti nr. {\*\*\*}, datë 11.04.2014, i Drejtorisë së Policisë Shkencore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, sipas të cilit lënda e sekuestuar në banesën e personit nën hetim, objekt ekspertimi, tregoi *për praninë e paracetamolit dhe kafeinës. Referencat për klasifikimin në lëndë narkotike apo jo gjenden në ligjin nr. 7975 të datës 26.07.1995 për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope*, subjekti i rivlerësimit ka pasur minimalisht detyrimin në kuadër të një hetimi të plotë, për të ballafaquar të arrestuarin me rezultatet e aktit toksikologjik. **Kryerja e veprimeve të plota dhe shteruese hetimore nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, duke qenë përpara dy fakteve të rëndësishme të ndryshme, atij të gjetjes në shtëpinë e personit nën hetim të një mase me praninë e paracetamolit dhe kafeinës, dhe nga kryerja e ekspertimit toksikologjiko-ligjor të urinës së të arrestuarit, rezulton se ai ishte përdorues, do të jepte një tablo më të qartë të kësaj çështjeje penale. Kur jemi përpara dy fateve të kundërta, hetimi duhet të shkojë më tej. Prandaj nuk jam dakord se këto veprime hetimore të ndërmarra nga prokurorja e çështjes të kenë qenë të plota.**

9. Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, në analizë të situatës të përshkruar në vendimin e shumicës, vlerësoj se në kushtet kur kallëzimi penal ishte bërë për dy persona, njëri nga ata bëhej ndaj një personi të njohur, ky fakt nuk mund të kalonte pa vëmendjen e drejtueses

së Prokurorisë, për më tepër kur kërkohet nga pala e interesuar se çfarë është bërë me kallëzimin e tij/saj. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit, në rastet kur delegon nënshkrimin për kthim përgjigje, duhet të jetë i vetëdijshëm, referuar edhe afatit të shkurtër të këtij delegimi, mbi të gjitha kur bëhet fjalë për persona të njohur.

Çmuj se është i drejtë pretendimi i Komisionerit Publik në ankim, se ndryshimet ligjore, përfshirë dhe ligjin nr. 97/2016, nuk duhen interpretuar në drejtim të mospërgjegjësive, rolit mbështetës dhe mbikëqyrës të drejtuesit të Prokurorisë, duke e kthyer drejtuesin e prokurorisë thjesht si nënshkruar shkresash përcjellëse dhe duke ia ngarkuar përgjegjësinë e ecurisë së procedimit penal vetëm prokurorit të çështjes, pasi kjo do të binte ndesh me rolin të cilin ligji ia jep drejtuesit të prokurorisë, me anë të kompetencave udhëzuese me natyrë jodetyruese, referuar nenit 43, germa “ç” dhe nenit 48, pikat 2, 3 dhe 4 të ligjit nr. 97/2016.

10. Lidhur me *denoncimin e regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.05.2021*, nga denoncues anonim, sipas të cilit Anita Jella, në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka favorizuar Oficerin e Policisë Gjyqësore E. Ç. [bashkëshortin e znj. A. M.], duke e paguar pa kryer asnjë punë, duke i sjellë dëm ekonomik institucionit, por nga ana tjetër edhe ka falsifikuar të dhënat zyrtare, të përgatitura nga vetë ajo, në kuadër të raportit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për vitin 2019, unë gjyqtare në pakicë ndaj mendim ndryshe nga shumica. Nga informacioni i administruar në Kolegj lidhur me këtë denoncim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.12.2021, ka informuar se OPGj E. Ç., për periudhën korrik – dhjetor 2019, ka qenë i ngarkuar për trajtimin e 22 çështjeve, ndërkohë që ka mbartur për vitin pasardhës 2020, 21 çështje penale. Në këto kushte, përfundimi nga OPGj-ja i vetëm një çështjeje penale, në vlerësimin tim nxjerr në pah pamjaftueshmërinë e veprimtarisë hetimore të kryer nga ky oficer i policisë gjyqësore për këtë periudhë.
11. Në përmbledhje të sa më sipër, bazuar në D, pikat 1, 2, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenin 61, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, kam votuar për ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 221, datë 10.12.2019, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Anita Jella.

## GJYQTARE

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, vendosa kundër shumicës në çështjen e rivlerësimit që i përket ankimit të Komisionerit Publik lidhur me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit [me numër 221, datë 10.12.2019], që konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Jella. Në vlerësimin tim, argumentet e Komisionerit Publik ishin të drejta dhe duheshin pranuar. Problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit pasuror për këtë subjekt, duhet të ishin konstatuar në drejtim të vlerësimit tërësor dhe cenimit të besimit të publikut, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 dhe 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”<sup>25</sup>. Në këtë dritë, kam vlerësuar edhe disa probleme të cilat, nëse analizohen në drejtim të perceptimit nga publiku të mënyrës se si funksionon sistemi i drejtësisë, parë bashkërisht me kriterin pasurisë, do të duhet të peshoheshin në drejtim të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, për të cilën kam votuar.
2. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, në ankimin e tij të mbështetur në rekomandimin e tre vëzhguesve ndërkombëtarë, Komisioneri Publik argumentoi se dështimi i subjektit për të deklaruar përdorimin e apartamentit në pronësi dhe ku jeton aktualisht<sup>26</sup> që nga viti 2011, parë së bashku me mungesën e burimeve të ligjshme për kryerjen e pagesës së këstit të parë të apartamentit, përbëjnë deklaram të pasaktë që passjell mosarritjen e nivelit të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit, përkundër pretendimeve të Komisionerit Publik, pretendoi që përdorimi nuk përbën të drejtë reale sipas Kodit Civil e, për pasojë, nuk kishte detyrim ta deklaronte apartamentin ndër vite dhe që kishte mjaftueshëm burime të ligjshme për të kryer pagesën e këstit të parë prej 2,5 milionë lekësh. Subjekti argumentoi që ndonjë mospërputhje që konstatohej, duhej të trajtohej në proporcionalitet. Shumica e trupit gjykues ra dakord me këtë këndvështrim të subjektit të rivlerësimit.
3. Nuk isha dakord me shumicën për sa më sipër, për disa arsye. Së pari, pretendimi që përdorimi i pasurive nuk ka qenë detyrim për deklaram ndër vite, parashtruar edhe nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, bie ndesh qoftë me gjuhën, ashtu edhe me frymën dhe arsyet racionale për të cilat ekziston procesi i deklarimit të pasurive nga funksionarët publikë sipas ligjit nr. 9049/2003<sup>27</sup>, përfshirë edhe në versionin që ishte në fuqi deri në ndryshimet e vitit 2017<sup>28</sup>. Ky pretendim nuk gjen pasqyrim në përcaktimin e nenit 4, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 9049/2003, i cili ia nënshtronte deklarimit “pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to”. Pikërisht për të rregulluar situatat në të cilat subjektet deklaruese sipas ligjit nr. 9049/2003, për

<sup>25</sup> Këto dy dispozita respektivisht parashikojnë si vijon: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave [...]”. Dhe: “5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”.

<sup>26</sup> Apartament me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, porositur në vlerën 71 900 euro, në Durrës, rruga “{\*\*\*}”, lagjia nr. {\*\*\*}.

<sup>27</sup> Neni 4 i ligjit nr. 9049/2003 përcakton: “[...] Subjektet [...] detyrohen të deklarojnë [...] gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë [...] si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil [...]. Udhëzimi në krye të faqes 3 të formularit rekomandon: “Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) [...] të çdo lloj pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë [...]”.

<sup>28</sup> Me ndryshimet e pësuara për shkak të ligjit nr. 47/2017 në nenin 4, pas të cilit në dispozitën e sipërcituar në poshtëshënimin nr. 3, është shtuar togfjalëshi “sipas Kodit Civil”.

arsye të ndryshme nuk janë pronarë të pasurive *de jure*, ligjvënësi ka përfshirë edhe detyrimin për deklarim të pasurive të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, si dhe të të drejtave reale. Nëse do të pranohej pretendimi i subjektit apo i shumicës në këtë interpretim, kjo kërkesë e shprehur e ligjit do të ishte pa peshë, e tepërt dhe e panevojshme. Sjell në vëmendje që subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, është sjellë si pronare e apartamentit në fjalë. Kjo dëshmohet hapur edhe nga investimet e kryera [dhe pranuar prej saj] në këtë apartament, sikurse edhe nga lidhja e kontratave utilitare për këtë apartament që nga viti 2011, si dhe nga fakti që në pikën fundore, ky ishte edhe apartamenti për të cilin ajo përfundimisht fitoi pronësinë, pasi e ka shkëmbyer me një apartament të porositur më herët dhe në vlerë më të ulët në të njëjtën ndërtesë<sup>29</sup>. Në këto kushte, pretendimi i subjektit, pranuar nga shumica, që përdorimi i apartamentit që nga viti 2011 nuk përbënte detyrim për subjektin për ta deklaruar, pavarësisht se rrethanat faktike dëshmojnë për sjellje prej pronari, është i pabazuar në ligj.

4. Përpos këtij mosdeklarimi dhe këmbënguljes së subjektit për të mënjeluar përgjegjësinë për këtë fakt, duke sjellë në ndihmë dhe shtrirë argumente të natyrës akademike të ligjit material civil në lëmin e deklarimit të pasurive, ndonëse ajo gëzonte, investonte mbi një pasuri të padeklaruar për vite me radhë dhe duke filluar nga viti 2012 (të paktën), edhe planifikonte të kryente këmbimin e pasurisë që përdorte me atë që kishte porositur, analiza financiare e kryer në Kolegj tregoi mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e këstit të parë për këtë apartament. Konkretisht, ndërsa në deklaratën e pasurisë [vetting] subjekti pretendon se ka paguar për “këstet” 2,5 milionë lekë nga kursimet në vite, në pyetësorë ajo është shprehur që ka paguar përreth 2 milionë lekë. Në analizën financiare të kryer në Kolegj për të përballuar shpenzimet dhe kursimet e deklaruara *cash* ndër vite jashtë sistemit bankar, subjekti rezulton me pamundësi në vlerën 770 mijë lekë (përafërsisht) në vitin 2011.
5. Shumica vlerësoi që të pranojë si vlerë të paguar për këstet, atë prej 2 milionë lekësh, sipas deklarimit të subjektit gjatë procesit të hetimit administrativ<sup>30</sup> që përkon me vlerën e këstit të parë prej 15 mijë eurosh. Kjo shumë është jo vetëm në mospërputhje me sa është deklaruar prej subjektit si shpenzim nga kursimet për apartamentin [përfshirë investimet në të], por është në mospërputhje edhe me vlerën që përftohet nëse kryhet një përlllogaritje matematikore e të ardhurave të deklaruara *cash* prej subjektit deri në fund të vitit 2010<sup>31</sup>. Në kushtet kur deklaratat e pasurisë në procesin e rivlerësimit ka peshë themelore, vlera për të cilën do të duhet të ishte kryer përlllogaritja, është ajo e deklaruar nën përgjegjësi nga subjekti në deklaratën *vetting*. Ky fakt merr rëndësi të veçantë nëse sillet në vëmendje që gjithë këto shuma përlllogariten mbi bazën e deklarimeve të vetë subjektit, znj. Anita Jella, e cila nuk solli asnjë provë shkresore për të dokumentuar vlerën e paguar apo shpenzimet e kryera me fatura. Në këto kushte, qëndrimi i shumicës është i pabazuar, pasi bie ndesh me detyrimin e nenit 49, pika 4<sup>32</sup> e ligjit nr. 84/2016 për të bazuar vendimin mbi dokumente dhe prova të besueshme. Për këto arsye, vlerësova që

---

<sup>29</sup> Apartament, porositur me kontratë sipërmarrjeje të datës 26 gusht 2011, me sipërfaqe 97 m<sup>2</sup>, në vlerë 67 900 euro, ndodhur në katin {\*\*\*} të së njëjtës ndërtesë me atë të përfutur në fund nga subjekti, ndodhur në katin {\*\*\*} dhe porositur fillimisht nga vëllai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

<sup>30</sup> Parashtrimet e rezultateve të hetimit administrativ, datë {\*\*\*}, faqe 1 dhe 2.

<sup>31</sup> Sipas përlllogaritjes së kryer në Kolegj, subjekti i rivlerësimit deri në fund të vitit 2010, kishte mundësi të posedonte në *cash* vlerën prej 1,7 milionë lekësh.

<sup>32</sup> Kjo dispozitë parashikon “4. [...] Kolegji i Apelitimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera [...]”.

subjekti ishte në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm pasi, ndërsa ishte kontradiktore në thëniet e saj krahasuar me dokumentacionin në fashikull, kishte edhe mungesë të burimeve për të kryer pagesën e kësteve të deklaruara prej asaj vetë.

6. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vlerësoj ndryshe nga shumica në përgjigje të dy aspekteve, e konkretisht: (i) procedimi penal me nr. {\*\*\*}, bazuar mbi kallëzimin penal të një individi kundër, ndër të tjerë, edhe një gjyqtareje të Gjykatës së Apelit Tiranë; dhe (ii) faktet e aluduara nga një denoncues anonim për favorizim të bashkëshortit të një magjistrateje, e cila ka mbajtur pozicione në krye të sistemit të prokurorisë.
7. Konkretisht, në rastin e procedimit penal që përfshinte edhe gjyqtaren Z. S. [{\*\*\*}], në kushtet kur kallëzuesja, siç referon, ka kaluar të paktën shtatë (7) vjet duke ndjekur të njëjtën çështje që rrjedh nga të drejtat e pretenduara prej saj të trashëgimisë nga i shoqi<sup>33</sup>, dhe ndër të tjera ka akuzuar edhe një gjyqtare të gjykatës së apelit për shpërdorim detyre, në cilësinë e drejtueses, subjekti duhej të kishte qenë proaktive në mënyrë që të shmangej çdo perceptim i mundshëm për pandëshkueshmëri të përforcuar nga vetë sistemi. Në këtë drejtim, vlerësoj që duke pasur parasysh natyrën e problematikës së trajtuar, parë edhe në këndvështrim të perceptimit të publikut për mënyrën se si funksionon drejtësia, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar vëmendje maksimale dhe të shtuar dhe të kishte qenë proaktive në përdorimin e të gjitha mjeteve ligjore për të treguar që akuzat për shpërdorim detyre nga një gjyqtare trajtohen me seriozitet maksimal nga prokurorët në pozicione drejtuese si ajo.
8. Nga i njëjti këndvështrim, në kushtet kur ndër punonjësit<sup>34</sup> e institucionit që ajo drejton, ishte edhe bashkëshorti i drejtueses së Prokurorisë së Përgjithshme, vëmendja që të shmangej çdo perceptim favorizimi i mundshëm nga ana e drejtuesit për shkak të lidhjes së ngushtë të një punonjësi të prokurorisë me funksionarin më të lartë të sistemit, qoftë edhe përkohësisht, duhet të ishte e shtuar, në shërbim të frymës së kolegjalitetit të brendshëm, por edhe të perceptimit të drejtësisë nga qytetarët. Statistikat e dërguara gjatë hetimit në Kolegj, tregojnë për një numër më të ulët çështjesh të përfunduara nga punonjësi krahasuar me homologët e tij. Vlerësoj që subjekti duhet të kishte qenë proaktive për të shmangur perceptimin e favorizimit në rastin konkret.
9. Bashkërisht, këta faktorë dhe kontradiksionet në deklaramit e subjektit të rivlerësimit, çmoj se do të duhet të ishin konstatuar në drejtim të cenimit të besimit të publikut, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

## **GJYQTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

---

<sup>33</sup> *Kallëzimi penal i znj. N. P., datë 14.05.2019.*

<sup>34</sup> *Oficeri i Policisë Gjyqësore, z. E. Ç., njëkohësisht bashkëshorti i Prokurores së Përgjithshme znj. A. M..*